RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

NR	PËRMBAJTJA	Faqe
I	**HYRJA** (Të dhëna mbi Projektraportine auditimit) **a.** Objektivat e qëllimit **b.** Identifikimi i çështjes **c.** Përgjegjësitë e strukturave drejtuese **d.** Përgjegjësitë e audituesve **e.** Kriteret e vlerësimit **f.** Standardet e auditimit	1-4
II	**Përshkrimi i auditimit** **1.** Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. **2.** Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdheniet e punës dhe pagave. **3.** Mbi verifikimin, realizimin dhe zbatimin të procedurave të prokurimit publik. **4.** Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. **5.** Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të Drejtorive Rajonale... **6.** Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	 6-15 6-21 22 22 23-45
III	**Gjetjet dhe rekomandimet**	45-48
IV	**Konkluzione dhe opinioni i auditimit**	48
V	**Dokumente shoqëruese**	48-50

I. Hyrje

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 64/1, datë 21.01.2020 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 21.01.2020 deri 12.03.2020, në subjektin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (këtu e në vazhdim ISHPSHSH) Tiranë, u krye auditimi i përputhshmërisë me objekt "Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoriatit Shtetëror të Punës... dhe shpenzimet vjetore të buxhetit".

"Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. F. Z — Përgjegjës Grupi
2. M. Ll — Auditues
3. G.Sh — Auditues
4. H.K — Auditues

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të ISHPSHSH Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me e aktivitetit ekonomik dhe financiar të ISHPSHSH, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të Drejtorive rajonale etj.

a)Titulli. **"***Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet*".
b)Marrësi. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

c)Objektivat dhe qëllimi.
Objektivi i auditimit të KLSH është dhënia e një opinioni objektiv dhe të pavarur, mbi zbatimin korrekt dhe me paanshmëri për shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave kushteve mbi të cilat është rënë dakord.
Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Raportimi i deviacioneve ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.
Auditimi jonë ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte te besueshme mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të MK në respektim të kuadrit ligjor rregullator në fuqi.*Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për*

qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

d) Subjekti i audituar: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, është institucioni i ngarkuar për kontrollin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore rregulluese që mbulojnë fushën e punës. Si një faktor i rëndësishëm i tregut të punës, jep kontribut në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës nga aktivitetet ekonomike në të gjithë vendin.
Krijimi i këtij institucioni daton në vitin 1994. Në formatin që është, ISHPSHSH është krijuar me VKM nr. 295, datë 20.03.2013 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHPSHSH-së" dhe funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 1, datë 07.01.2014 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore"*.
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ushtron aktivitetin e tij si institucion ekzekutiv në si Institucion varësie i Ministrisë, Financave dhe Ekonomisë. Puna e tij monitorohet dhe mbikëqyret nga Inspektorati Qëndror.
ISHPSHSH-ja ushtron funksionet e saj mbështetur kryesisht në Ligjin nr. 9634/2006 "Për inspektimin e punës" i ndryshuar, dhe Ligjin nr 10433/2011 "Per inspektimin në RSH" i ndryshuar,
ISHPSHSH ka për mision kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe të atij të shërbimeve shoqërore.
Inspektimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

d) Identifikimi i çështjes.
Referuar çështjeve të audituara sipas programit, objektivi kryesor është dhënia e një opinioni nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:
-janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbi kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe të atij të shërbimeve shoqërore.
-janë përdorur fondet në funksion të veprimtarisë institucionale në përputhje me detyrimet ligjore.

e)Kriteret e vlerësimit.
-Kushtetuta e Shqipërisë, neni 162-163
-Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",
Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.107, datë 08.8.2017,
- Ligji nr. 9634/2006 "Për inspektimin e punës" i ndryshuar,
- Ligji nr 10433/2011 "Per inspektimin në RSH" i ndryshuar etj,

f)Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës janë:
-Standardet INTOSAI-t (ISSAI 4100,4200)
-eksperienca në terren (ISHPSHSH).

g) Përgjegjësitë e audituesve. Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200 [1]) e vlerësimit nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionëet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

h)Kriteret e vlerësimit. Projekt Raporti duhet të identifikojë legjislacionin bazë e dytësor, dhe/ose dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu janë referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019:

Auditimi u krye *për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2019,* duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
- Ligji nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017";
- Ligji nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018";
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- VKM nr. 285, datë datë 01.04.2015 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016-2018";
- VKM nr. 696, datë datë 31.07.2015 "Për tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018";
- Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm";
- Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm";
- Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019";
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 16.01.2015;
- Udhëzim nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore";
- Ligji nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03 2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"

<u>Hartimi i buxhetit për vitin 2017:</u>

Në zbatim të Ligjit nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" me shkresën 19659/1, datë 20.02.2018, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore i është dërguar detajimi i fondeve buxhetore dhe shpenzimeve kapitale në shumën totale **68,150,000** lekë. Këto fonde janë shpërndarë sipas zërave në programin buxhetor.

Referuar ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", i ndryshuar me aktet normative nr.1,2, të dala në vitin 2018 për rishikim të buxhetit, shumat e alokuara në fillim të vitit për programin buxhetor me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1 *në /lekë*

	Emrtimi	Buxheti fillestar 2017	Ndryshimet AN	Buxheti 2017 (I ndryshuar)	Realizimi FAKT	%
-	A	b	c	d	e	F
1	Paga Artikulli 600	29,300,000	+ 4,500,000	33,800,000	33,334,398	94%
2	Sigurimet shoqërore Artikulli 601	5,000,000	+ 650,000	5,650,000	5,499,320	97%

3	Artikulli 602	30,850,000	-800,000	30,050,000	29,544,902	98%
4	Investime 231	3,000,000	-	3,000,000	-	
5						
	Totali	**68,150,000**	**4,350,000**	**72,500,000**	**68,378,620**	**94%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Gjatë këtij viti, me aktet ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar në vlerën 68,150,000 lekë, është ndryshuar duke u shtuar dhe paksuar gjithsej në vlerën 4,350,000 lek. Plani i buxhetit përfundimtar i ISHPSHSH për vitin 2017 është 72,500,000 lekë ku rezulton i realizuar në vlerën 68,378,620 lekë. Ndryshimet në pakësim të vlerës fillestare janë bërë në të gjitha zërat: Fondi i pagave është rritur në vlerën + 4,500,000 lekë, Sigurimet shoqërore në vlerën + 650,000 lekë, Shpenzime operative janë ulur në vlerën -800,000 lekë,

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se në asnjë prej zëravë nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor. Në total realizimi vjetor është realizuar 94 % e fondeve të alokuara.

Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë për vitin 2017, paraqitet në tabelën nr.2

Tabela nr. 2 Realizimi i shpenzimeve Viti 2017 Në / lekë

Nr.	EMERTIMI	VITI 2017		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	34,120,000	33,334,398	98%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	5,520,000	5,499,320	99%
3	Shpenzime operative, art. (602)	30,222,787	30,214,219	98%
4	Transferta korente te brendshme (604)	-	-	-
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)	-	-	-
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	**69,862,787**	**69,047,937**	**99%**
1	Investime, art. (230)	-	-	-
2	Investime , art. (231)	3,000,000	-	-
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale	**3,000,000**	-	-
	BUXHETI	**72,862,787**	**69,047,937**	**95%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2017, paraqiten me mosrealizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 33,334,398 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 34,120,000 lekë ose 98 %,

Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 5,499,320 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 5,520,000 lekë ose 99%, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 30,214,219 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 30,222,787 lekë ose 98 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 69,047,937 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 69,862,787 lekë ose 99 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 0 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 3,000,000 lekë. Në total buxheti është realizuar në vlerën **69,047,937** lekë kundrejt planifikimit në vlerën **72,862,787** lekë (-3,814,850 lekë) ose 95 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor paraqitet në tabelën nr.3.

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2017	Realizuar 2017	Ne %
	602	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**1,270,000**	**1,717,168**	**135%**
1	602.01	Kancelari	670,000	536,400	80%
2		Boje Printeri	120,000	652,000	54%
3	602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	120,000	99,790	83%
5	602.03	Disifektim zyrash	120,000	99,750	83%
5	602.04	Lyerje Zyre	-	117,360	-
6	602.05	Riparim Dere	-	48,240	-
7	602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	-	-	-
		Moket	120,000	75,450	63%
		Grila	120,000	88,178	73%

	602.1	**Materiale dhe sherbime speciale**	**300,000**	**232,170**	**77%**
8	602.1001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	-	-	-
9	602.1002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera	-	-	-
10	602.1003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	-	-	-
11	602.1007	Abonime	150,000	148,374	99%
12	602.1009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik	-	-	-
13	602.101	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	-	-	-
14	602.1011	Softe informatike me karakter te pergjithshem	-	-	-
15		Mirembajtje rrjeti	-	57,700	-
16	6022099	Internet/USB	-	-	-
17	6022099	Ndertim matrice	-	-	-
18	6022099	Pilotim matrice	-	-	-
19	6022099	Upgrade	-	-	-
20	6021099	Materiale special	-	-	-
21	602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	-	-	-
22		Blerje ceku	-	-	-
23		Materiale te pergjitshme	-	-	-
24		Investime	-	-	-
25		Shperndarje Interneti	150,000	26,096	17%
	602.2	**Sherbime nga te trete**	**5,506,059**	**4,176,271**	**76%**
26	602.2001	Elektricitet	1,300,000	912,657	70%
27		Materiale elektrike	50,000	-	-
28		Shtese Fuqie		233,746	-
		Diferenca energji elektirke		7,485	-
29	**602.2002**	**Uje**	-	-	-
30	602.2003	Sherbime telefonike	150,000	103,651	69%
31	602299	Uje lidhje	-	-	-
32		Sherbim interneti	-	-	-
33		Telefoni Celulare	-	-	-
34		**AMC**	150,000	90,908	60%
35		**Vodafone**	-	-	-
36	602.2004	Posta dhe sherbimi korrier	-	98,556	-
37	602.2007	Sherbimet bankare	-	-	-
38	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes **(1)**	413,629	413,628	100%
39		Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes **(2)**	2,892,430	2,315,640	80%
40	602.201	Sherbime te printimit dhe publikimit	400,000	-	-
41	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve	-	-	-
42	602.2099	Sherbime te tjera	-	-	-
43		Projekt zyre zbatim	-	-	-
	602.3	**Shpenzime transporti**	**2,980,000**	**2,245,433**	**75%**
44	602.31	Karburant dhe vaj	300,000	299,891	100%
45		Karburant dhe vaj	1,500,000	1,004,130	67%
		Benzine	200,000	-	-
46	602.32	Goma makine	-	-	-
47		Riparim makine	700,000	711,569	101%
49		Siguriacion makine	60,000	96,286	160%
50		Lavazh makine	120,000	73,600	61%
51		Taksa makine	100,000	59,957	59%
52		Gjoba makine	-	-	-
53		Kolaudim	-	-	-
54		Nderrim filtra	-	-	-
55			-	-	-
56	602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	-	-	-
57	602.39	Shpenzime te tjera transporti	-	-	-
	602.4	**Shpenzime udhetimi**	**2,833,941**	**2,360,890**	**83%**
58	602.4	Udhetim i brendshem	2,133,941	2,360,890	111%
59	602.41	Udhetim jashte shtetit	700,000	-	-
60			-	-	-
	602.5	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**240,000**	**120,000**	**50%**
61	602.5	Shpenzime per mirembajtjen e tokave	-	-	-
62	602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	-	-	-
63	602.53	Shpenzime per riparim i rrjetit te ajrit te kondicionuar	120,000	120,000	100%
64		Shpenzime riparim kompjuteri	120,000	-	-
65	602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve,	-	-	-
66	602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	-	-	-
67	602.58	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	-	-	-
	602.6	**Shpenzime per qeramarrje**	**-**	**-**	**-**
68	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	-	-	-

69	602.63	Shpenzime per qeramarrje per aparate	-	-	-
70	602.69	Shpenzime te tjera qeraje	-	-	-
	602.7	**Shpenzime per vendime gjygji**	-	-	-
	602.9	**Shpenzime te tjera operative**	**17,720,000**	**19,362,287**	**109%**
71	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	100,000	-	-
72	602.9001	Shpenzime gjygjesore	-	-	-
73	6027400	Vendime Gjyqesore	17,000,000	19,191,957	113%
74	602.9005	Shpenzime per honorare	-	-	-
75	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	-	-	-
76	602.9008	Shpenzime fature arketimi	-	30,200	-
77	602.9	Shpenzime per tatime & taksa	-	-	-
78		Shpenzime per trajnime	-	-	-
79		Shpenzime taksa bashkie	-	140,130	-
80		Shpenzime konsulence	-	-	-
81		Te tjera	200,000	-	-
82		Mirembajtje	120,000	-	-
83		Reklama	300,000	-	-
84		Takime mbledhje	-	-	-
Totali Mallra dhe Sherbime			**30,222,787**	**30,214,219**	**98%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme rezulton se, realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2018, është 30,222,787 kundrejt planifikimit me vlerë 30,214,219 lekë ose 98%.

Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 602, zëri materiale zyre dhe të përgjithshme, janë kryer shpenzime në masën 35 % më shumë se planifikimi. Janë realizuar nën zëra të pa planifikuar si lyerje e zyrave, rregullim dere, me vlerë 165,600 lek. Në zërin materiale dhe shërbime speciale janë kryer shpenzime për mirëmbajtje rrjeti në vlerën 57,700 lekë të pa planifikuara. Në zërin shërbime nga te tretet janë kryer shpenzime të paplanifikuara për nën zëra si shtesë fuqie me vlerë 233,746 lekë, posta dhe shërbim korrieri me vlerë 98,556 lekë. Në zërin shpenzime te tjera operative janë kryer shpenzime për fature arkëtimi të pa planifikuara me vlerë 30,200 lekë, shpenzime për taksa bashkie me vlerë 140,130 lekë. Në total vlera e shpenzimeve të kryera pa planifikim për vitin 2017 është 725,732 lekë ose 2.4% e vlerës së realizuar. Pavarësisht se institucioni nuk ka tejkalim të artikullit 602, shpenzime operative në zëra të veçantë konstatohet tejkalim në realizimi kundrejt planifikimit . Kështu në zërin material zyre dhe të përgjithshme planifikimi është në vlerën 1,270,000 lekë dhe realizimi në vlerën 1,717,168 lekë ose 135 %, në nën zërin siguriacion makine planifikimi është në vlerën 60,000 lekë dhe realizimi në vlerën 96,286 lekë ose 160 %, për udhëtime të brendshme, dieta planifikimi është në vlerën 2,133,941 lekë dhe realizimi në vlerën 2,360,890 lekë ose 111 %, për vendime Gjyqësore planifikimi është në vlerën 17,000,000 lekë dhe realizimi në vlerën 19,000,000lekë ose 113 %.

Hartimi i buxhetit për vitin 2018:

Në zbatim të Ligjit nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" me shkresën 19659/153, datë 20.02.2018, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore i është dërguar detajimi i fondeve buxhetore dhe shpenzimeve kapitale në shumën totale **68,150,000** lekë. Këto fonde janë shpërndarë sipas zërave të programit buxhetor.

Referuar ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", i ndryshuar me Aktet Normative të dala në vitin 2018, për rishikim të buxhetit, shumat e alokuara në fillim të vitit për programin buxhetor me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1 *në /lekë*

	Emrtimii	Buxheti fillestar 2018	Ndryshimet AN	Buxheti 2018 (I ndryshuar)	Realizimi FAKT	%
-	A	b	c	d	e	f
1	Paga Artikulli 600	35,000,000	-444,000	34,556,000	31,513,795	91%

2	Sigurimet shoqërore Artikulli 601	6,765,775	-56,000	6,709,775	5,203,408	78%
3	Artikulli 602	33,050,000	-3,584,180	29,465,820	25,565,076	87%
4	Investime 231	10,000,000	-25,000	9,975,000	9,912,000	99%
5						
	Totali	**84,815,775**	**4,109,180**	**80,706,595**	**72,194,279**	**89%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Për vitin 2018, me aktet ligjore e nënligjore, buxheti fillestar i alokuar në vlerën 84,815,775 lekë, në fillim të vitit, për ISHPSHSH është ndryshuar duke u paksuar gjithsej në vlerën 4,109,180 lekë. Plani i buxhetit përfundimtar i ISHPSHSH për vitin 2018 është 80,706,595 lekë, ku rezulton i realizuar në vlerën 72,194,279 lekë ose 89% e fondeve të alokuara.

Ndryshimet në pakësim të vlerës fillestare janë bërë në të gjitha zërat: Fondi i pagave është paksuar në vlerën -444,000 lekë, Sigurimet shoqërore në vlerën -56,000 lekë, Shpenzime operative janë ulur në vlerën -3,584,180 lekë, investimet (231) janë pakësuar në vlerën -25,000 lekë.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se në asnjë prej zëravë nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor.

Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë për vitin 2018, paraqitet në tabelën nr.2.

Tabela nr. 2 Realizimi i shpenzimeve Viti 2018 Në /lekë

Nr.	EMERTIMI	VITI 2018		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	34’556’000	31’513’795	91%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	6’709’775	5’203’408	78%
3	Shpenzime operative, art. (602)	29’465’820	25’565’076	87%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)			
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	**70,731,595**	**62,282,279**	88%
1	Investime, art. (230)			
2	Investime , art. (231)	9’975’000	9’912’000	99%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale			
	BUXHETI	**80,706,595**	**72,194,279**	**89%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2018, paraqiten me mos realizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 31’513’795 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 34’556’000 lekë ose 91 %,

Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 5’203’408 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 6’709’775 lekë ose 78%, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 25’565’076 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 29’465’820 lekë ose 87 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 62,282,279 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 70,731,595 lekë ose 88 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 9’912’000 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 9’975’000 lekë. Në total buxheti është realizuar në vlerën 72,194,279 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 80,706,595 lekë (-8,512,316 lekë) ose 89 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor paraqitet në tabelën nr.3.

Tabela nr.3 Realizimi i shpenzimeve operative Në /lekë

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Ne %
	602	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**1,900,000**	**1,454,520**	**76%**
1	602.01	Kancelari	800’000	690’720	86%
2		Boje Kompjuteri	800’000	593’400	74%
3	602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	300’000	170’400	57%
5	602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	-	-	-
5	602.04	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	-	-	-
6	602.05	Blerje dokumentacioni	-	-	-
7	602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	-	-	-

	602.1	**Materiale dhe sherbime speciale**	**150,000**	**2,461,039**	164
8	602.1001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	-	-	-
9	602.1002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera	-	-	-
10	602.1003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	-	-	-
11	602.1007	Abonime	150’000	94’368	63%
12	602.1009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik	-	-	-
13	602.101	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	-	-	-
14	602.1011	Softe informatike me karakter te pergjithshem	-	-	-
15		Mirembajtje rrjeti	-	120’000	-
16	6022099	Internet/USB	-	48’349	-
17	6022099	Ndertim matrice	-	942’000	-
18	6022099	Pilotim matrice	-	944’640	-
19	6022099	Upgrade	-	225’000	-
20	6021099	Materiale speciale	-	4’640	-
21	602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	-	-	-
22		Blerje ceku	-	1’400	-
23		Materiale te pergjitshme	-	80’642	-
24		Investime	-	-	
25		Mallra sherbime	-	-	
	602.2	**Sherbime nga te trete**	**6,005,222**	**4,219,634**	70%
26	602.2001	Elektricitet	1’200’000	1’070’061	89%
27		Materiale elektrike	120’000	36’000	30%
28			-	-	-
29	**602.2002**	**Uje**	150’000	-	-
30	602.2003	Sherbime telefonike	150’000	101’694	68%
31	602299	Uje lidhje	-	8’015	-
32		Sherbim interneti	-	-	-
33		Telefoni Celulare	-	-	-
34		**AMC**	120’000	24’090	20%
35		**Vodafone**	-	67’789	-
36	602.2004	Posta dhe sherbimi korrier	150’000	166’394	111%
37	602.2007	Sherbimet bankare	-	-	-
38	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes **(1)**	573’773	1’275’609	222%
39		Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes **(2)**	3’541’449	1’457’982	41%
40	602.201	Sherbime te printimit dhe publikimit	-	-	-
41	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve	-	-	-
42	602.2099	Sherbime te tjera	-	-	-
43		Projekt zyre zbatim	-	12’000	-
	602.3	**Shpenzime transporti**			
44	602.31	Karburant dhe vaj	300’000	495’842	165%
45		Karburant dhe vaj	2’000’000	1’504’117	75%
46	602.32	Goma makine	300’000	226’800	76%
47		Riparim makine	700’000	667’600	95%
49		Siguriacion makine	150’000	144’533	96%
50		Lavazh makine	150’000	91’600	61%
51		Taksa makine	100’000	75’839	76%
52		Gjoba makine	-	30’200	-
53		Kolaudim	-	11’340	-
54		Nderrim filtra	100’000	89’242	89%
55			-	-	-
56	602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	-	-	-
57	602.39	Shpenzime te tjera transporti	-	-	-
	602.4	**Shpenzime udhetimi**	**4,179,919**	**3,629,207**	**87%**
58	602.4	Udhetim i brendshem	1’679’919	3’507’680	209%
59	602.41	Udhetim jashte shtetit	2’500’000	121’527	5%
60			-	-	-
	602.5	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**800,000**	**240,000**	**30%**
61	602.5	Shpenzime per mirembajtjen e tokave	-	-	-
62	602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	-	-	-
63	602.53	Shpenzime per riparim i rrjetit te ajrit te kondicionuar	300’000	120’000	40%
64		Shpenzime riparim kompjuteri	500’000	120’000	24%
65	602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve,	-	-	-
66	602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	-	-	-
67	602.58	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	-	-	-
	602.6	**Shpenzime per qeramarrje**	**-**	**-**	**-**
68	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	-	-	-
69	602.63	Shpenzime per qeramarrje per aparate	-	-	-
70	602.69	Shpenzime te tjera qeraje	-	-	-

	602.7	**Shpenzime per vendime gjygji**	-	-	-
	602.9	**Shpenzime te tjera operative**	**12,630,679**	**10,223,563**	**81%**
71	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	400'000	-	-
72	602.9001	Shpenzime gjygjesore	-	161'181	-
73	6027400	Vendime Gjyqesore	10'475'102	9'608'158	92%
74	602.9005	Shpenzime per honorare	-	-	-
75	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	-	-	-
76	602.9008	Shpenzime fature arketimi		137'759	
77	602.9	Shpenzime per tatime & taksa	-	-	-
78		Shpenzime per trajnime	200'000	120'000	60%
79		Shpenzime taksa bashkie	200'000	146'465	73%
80		Shpenzime konsulence	100'000	50'000	50%
81		Te tjera	515'820	-	-
82		Mirembajtje	300'000	-	-
83		Reklama	139'757	-	-
84		Takime mbledhje	300'000	-	--
Totali Mallra dhe Sherbime			**29'465'820**	**25'565'076**	**87%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme rezulton se, realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2018, është 25'565'076 kundrejt planifikimit me vlerë 29'465'820 lekë ose 87%. Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 602, në zërin materiale dhe sherbime speciale janë kryer shpenzime pë pa planifikuara për nën zërat mirembajtje rrjeti në vlerë 120'000 lekë, Internet/USB në vlerë 48'349 lekë, Ndertim matrice në vlerë 942'000 lekë, Pilotim matrice në vlerën 944'640 lekë, Upgrade në vlerën 225'000 lekë, Materiale special në vlerë 4'640, Blerje ceku me vlerë 1'400 lekë, Materiale te pergjitshme me vlerë 80'642 lekë. Në total shpenzimet e paplanifikuara në zërin materiale dhe sherbime special janë në vlerën 2,366,671 lekë. Në zërin sherbime nga të tretet janë kryer shpenzime të paplanifikura për nën zëra si Projekt zyre zbatim me vlerë 12,000 lekë, në zërin shpenzime transporti janë kryer shpenzime të paplanifikuara ne nen zërin Gjoba makine me vlerë 30'200, Kolaudim me vlerë 11'340 lekë. Në zërin shpenzime te tjera operative janë kryer shpenzime për shpenzime gjyqësore të pa planifikuara me vlerë 161'181 lekë, shpenzime faturë arketimi me vlerë 137'759 lekë. Në total vlera e shpenzimeve të kryera pa planifikim për vitin 2018 është 2,719,151 lekë ose 10,6% e vlerës së realizuar. Pamvarësisht se institucioni nuk ka tejkalim të artikullit 602, shpenzime operative në zëra të vecantë konstatohet tejkalim në realizimi kundrejt planifikimit . Kështu në zërin material dhe shërbime speciale planifikimi është në vlerën 150,000 lekë dhë realizimi në vlerën 2,461,039 lekë ose 164 %, në nënzërin Posta dhe sherbimi korrier planifikimi është në vlerën 150'000 lekë dhë realizimi në vlerën 166'394 lekë ose 111 %, për Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes **(1)** është në vlerën 573'773 lekë dhë realizimi në vlerën 1'275'609 lekë ose 222 %, për Karburant dhe vaj është në vlerën 300,000lekë dhe realizimi në vlerën 495'842 lekë ose 165 %, për Udhetim i brendshem planifikimi është në vlerën 1'679'919 dhe realizimi në vlerën 3'507'680 ose 209%.

Hartimi i buxhetit për vitin 2019:

Në zbatim të Ligjit nr.89/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03 2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" me shkresën 22760, datë 27.12.2018, Inspektoriatit shtetëror të punësimit dhe Sherbimeve Shoqerore, i është dërguar detajimi i fondeve buxhetore dhe shpenzimeve kapitale në shumën totale 193,768,000 lekë. Këto fonde janë shpërndarë sipas zërave të programit buxhetor.

Referuar ligjit nr.89/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", i ndryshuar me Aktet Normative të dala në vitin 2019, për rishikim të buxhetit, shumat e alokuara në fillim të vitit për programin buxhetor me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1 *në /lekë*

	Emërtimi	PBA	Buxheti	Ndryshime	Buxheti	Realizimi	%

			fillestar 2019	AN	2019 (I ndryshuar)	FAKT	
-	A		b	c	d	e	f
1	Paga Artikulli 600	120,278,000	126,800,000	34,302,811	92,497,189	79,599,113	86%
2	Sigurimet shoqërore Artikulli 601	20,086,000	22,340,000	5,137,736	17,202,264	13,151,642	76%
3	Shpenzime operative Artikulli 602	47,953,000	34,328,000	2,189,923	32,138,077	22,408,308	70%
4	Investime 231	50,706,000	10,000,000	10,000,000	-	-	-
5	Artikulli 606	-	300,000	-	300,000	296,000	99%
	Totali	**239,023,000**	**193,768,000**	**41,630,470**	**152,137,530**	**115,455,063**	**76%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Për vitin 2019, me aktet ligjore e nënligjore, buxheti fillestar i alokuar në vlerën 193,768,000 lekë, në fillim të vitit, për ISHPSHSH është ndryshuar duke u paksuar gjithsej në vlerën 41,630,470 lekë. Plani i buxhetit përfundimtar i ISHPSHSH për vitin 2019 është 152,137,530 lekë, ku rezulton i realizuar në vlerën 115,455,063 lekë ose 76% e fondeve të alokuara.

Ndryshimet në pakësim të vlerës fillestare janë bërë në të gjitha zërat: Fondi i pagave është paksuar në vlerën -34,302,811 lekë, Sigurimet shoqërore në vlerën -5,137,736 lekë, Shpenzime operative janë ulur në vlerën -2,189,923 lekë, investimet (231) janë pakësuar në vlerën -10,000,000 lekë.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se në asnjë prej zëravë nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor. Artikulli 606 nuk ka pësuar ndryshime duke ruajtur vlerën e planifikuar në buxhetin fillestar.

Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë për vitin 2019, paraqitet në tabelën nr.2.

Tabela nr. 2 Realizimi i shpenzimeve Viti 2019 Në /lekë

Nr.	EMERTIMI	VITI 2019		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	92,497,189	79,599,113	86%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	17,202,264	13,151,642	76%
3	Shpenzime operative, art. (602)	32,138,077	22,408,308	70%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)	300,000	296,000	99%
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	**142,137,000**	**115,455,063**	81%
1	Investime, art. (230)			
2	Investime , art. (231)	10,000,000	0	0%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale	**10,000,000**	**0**	**0%**
	BUXHETI	**152,137,530**	**115,455,063**	**76%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2019, paraqiten me mos realizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 79,599,113 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 92,497,189 lekë ose 86 %,

Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 13,151,642 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 17,202,264 lekë ose 76%, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 22,408,308 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 32,138,077 lekë ose 70 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 115,455,063 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 142,137,000 lekë ose 81 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 0 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 10,000,000 lekë. Në total buxheti është realizuar në vlerën 115,455,063 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 152,137,530 (-36,682,467 lekë) ose 76 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor paraqitet në tabelën nr.3.

Tabela nr.3 Realizimi i shpenzimeve operative Në /lekë

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2019	Realizuar 2019	Ne %
	602	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**8,977,753**	**2,413,899**	**27%**
			5,815,077	**-**	**-**

		Fatura 2018	862,676	862,676	100%
1	602.01	Kancelari	800,000	734,628	92%
2	602.09	Boje Kompjuteri	800,000	481,408	60%
3	602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	500,000	285,600	57%
5	602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	-	-	-
6	602.04	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	-	-	-
7	602.05	Blerje dokumentacioni	100,000	-	0%
8	602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	-	-	-
9	602.09	Ngrohesa elektrike	100,000	49,587	50%
	602.1	**Materiale dhe sherbime speciale**	**1,400,000**	**792,868**	**57%**
10	602.1001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	-	-	-
11	602.1002	Blerje fidane	-	96,000	-
12	602.1003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	-	75,720	-
13	602.1007	Abonime	-	-	-
14	602.1009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik	-	-	-
15	602.101	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	-	-	-
16	602.1011	Softe informatike me karakter te pergjithshem	-	-	-
17	6025400	Mirembajtje rrjeti	500,000	-	-
18	6022099	Internet/USB	400,000	306,148	77%
19	6022099	Ndertim matrice	-	-	-
20	6022099	Pilotim matrice	-	-	-
21	6022099	Upgrade	60,000	60,000	100%
22	6021099	Materiale special(riparim vendroje)	200,000	167,000	84%
23	602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	-	-	-
24		Blerje ceku	-	-	-
25	6021099	Panorama	120,000	88,000	73%
26	6021099	Lule	120,000	-	-
27		Materiale te pergjitshme	-	-	-
28		Investime	-	-	-
29		Mallra sherbime	-	-	-
	602.2	**Sherbime nga te trete**	**6,510,000**	**7,371,708**	**113%**
30	602.2001	Elektricitet	1,200,000	1,467,197	122%
31		Materiale elektrike	-	-	-
32			-	-	-
33	**602.2002**	**Uje**	60,000	106,931	178%
34	602.2003	Sherbime telefonike	110,000	157,172	143%
35	602299	Uje lidhje	-	-	-
36		Sherbim interneti	-	-	-
37		Telefoni Celulare	120,000	110,000	91%
38		**Eagle mobile**	-	25,040	-
39		**Vodafone**	-	-	-
40	602.2004	Posta dhe sherbimi korrier	200,000	284,184	142%
41	602.2007	Sherbimet bankare	-	-	-
42	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	3,900,000	4,801,184	123%
43	602.201	Sherbime te printimit dhe publikimit	-	-	-
44	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve	-	420,000	-
45	6022099	Moket	120,000	-	-
46	602.2099	Sherbime te tjera	-	-	-
47	6029099	Projekt zyre zbatim	800,000	-	-
	602.3	**Shpenzime transporti**	**3,280,800**	**1,916,335**	**58%**
48	602.31	Karburant dhe vaj	2,000,000	866,235	43%
49	6023200	Blerje Goma	-	118,200	-
50	602.32	Pjese kembimi	-	-	-
51	6023200	Riparim makine	500,000	-	-
52	6023300	Siguriacion makine	200,000	144,533	72%
53	6023900	Lavazh makine	300,800	80,500	27%
54	6023900	Taksa makine	100,000	354,925	355%
55		Gjoba makine	-	-	-
56	6023900	Kolaudim	-	17,990	-
57	6023900	Nderrim filtra	180,000	88,392	49%
58	602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	-	-	-
59	602.39	Shpenzime te tjera transporti	-	245,560	-
	602.4	**Shpenzime udhetimi**	**7,000,000**	**4,978,424**	**71%**
60	602.4	Udhetim I brendshem	6,000,000	4,199,610	70%
61	602.41	Udhetim jashte shtetit	1,000,000	778,814	78%
			-	-	-
	602.5	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**500,000**	**1,630,900**	**326%**

	602.5	Shpenzime per mirembajtjen e tokave	-	-	-
	602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	-	-	-
	602.5800	Shpenzime per riparim i rrjetit te ajrit te kondicionuar	200,000	94,800	47%
	6025300	Mirembajtje zyre	-	74,500	-
	6025800	Shpenzime riparim kompjuteri	300,000	117,600	39%
	602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, dixhitalizim	-	1,344,000	-
	602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	-	-	-
	602.58	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	-	-	-
	602.6	**Shpenzime per qeramarrje**	**0**	**969,000**	**-**
	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	-	969,000	-
	602.63	Shpenzime per qeramarrje per aparate	-	-	-
	602.69	Shpenzime te tjera qeraje	-	-	-
	602.7	**Shpenzime per vendime gjygji**	-	-	-
	602.9	**Shpenzime te tjera operative**	**4,469,524**	**2,335,174**	**52%**
	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	200,000	42,664	21%
	602.9001	Shpenzime gjygjesore	165,000	105,100	64%
	6027400	Vendime Gjyqesore	1,000,000	900,118	90%
	6029003	Tarife permbarimore	-	31,200	-
	6027500	Gjoba tatime	-	234,929	-
	602.9005	Shpenzime per honorare	-	-	-
	6029004	Sigurim jete	357,000	-	-
	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	-	-	-
	602.9008	Shpenzime fature arketimi	-	-	-
	602.9	Shpenzime per tatime & taksa (tatim burim)	-	213,946	-
		Shpenzime per trajnime	200,000	-	-
		Shpenzime taksa bashkie	200,000	695,117	347%
		Shpenzime konsulence	200,000	-	-
		Te tjera	1,747,524	-	-
	6022099	Mirembajtje	200,000	-	-
		Reklama	-	-	-
	6026100	Takime mbledhje	200,000	112,100	56%
Shuma Mallra dhe Sherbime					
Detyrime					
Totali Mallra dhe Sherbime			**32.138.077**	**22.408.308**	**70%**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme rezulton se, realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2019, është 22.408.308 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 32.138.077 lekë ose 70%. Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 602, shpenzime operative rezulton se nga 32.138.077 lekë të planifikuara janë shpërndarë sipas zërave të kësaj llogarie vjera 25,323,000 lekë duke lënë pa shpërndarë vlerën 5,815,077 lekë. Në zërin materiale dhe sherbime speciale janë kryer shpenzime të pa planifikuara për nën zërat blerje fidane, Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore gjithsej në vlerën 171,720 lekë. Në sherbime nga te trete janë kryer shpenzime të pa planifikuara në vlerën 445,040 lekë. Në shpenzime transporti janë kryer shpenzime të pa planifikuara në vlerën 381,750 lekë. Në shpenzime per mirembajtje te zakonshme janë kryer shpenzime të pa planifikuara në vlerën 1,418,500 lekë. Në shpenzime per qeramarrje janë kryer shpenzime të pa planifikuara në vlerën 969,000 lekë. Në shpenzime te tjera operative janë kryer shpenzime të pa planifikuara në vlerën 480,075 lekë.

Në total vlera e shpenzimeve të kryera pa planifikim për vitin 2019 është 3,866,085 lekë ose 17% e vlerës së realizuar.

Nga auditimi i llogarisë 602, shpenzime operative konstatohet se edhe pse në total këto shpenzime janë realizuar në masën 70%, ka zëra të cilët janë realizuar mbi 100%. Kështu nën zëri sherbime nga te trete është realizuar 113%, ku elektriciteti është realizuar 122%, uji 178%, shërbime telefonike 143%, shërbimi postar 142%, sherbime te sigurimit dhe ruajtjes 123%. Nënzëri shpenzime transporti është realizuar 58% por taksa e makinave është realizuar 355%. Zëri shpenzime per mirembajtje te zakonshme është realizuar 326%. Zëri shpenzime te tjera operative është realizuar 52% por taksat e bashkisë rezultojnë të realizuara 347%.

Nga raporteve të monitorimit rezultoi:

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit të vitit 2017, 2018 si dhe për vitin 2019. Mungon Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2017.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2018 dhe vitit 2019, të cilat SHKP i ka paraqitur në Ministrisë e Financave, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me kreun IV "*Monitorimi*", të Udhëzimit nr. 9, dt. 20.03.2018 "*Përprocedurat standarte të zbatimin e buxhetit*" të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku citohet se " *Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet të përmbajë:*

- *Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;*
- *Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;*
- *Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashi-kohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;*

Në raportet e monitorimit mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimet dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre. ISHPSHSH nuk ka bërë publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyratare.

<u>Të ardhurat dytësore</u>

Për periudhën objekt auditimi ISHPSHSH, ka mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 52,636,704 lekë, nga të cilat për vitin 2017 në vlerën 11,848,007 lekë, në vitin 2018 në vlerën 14,048,219 dhe për vitin 2019 në vlerën 26,740,478 lekë.

	EMERTIMI	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Të ardhura nga qeraja	149,100	319,500	42,600
2	Kamat vonesat	1,005,679	764,761	559,278
3	Të ardhurat nga gjobat	10,693,228	12,963,958	26,138,600
	Totali i arktimeve	**11,848,007**	**14,048,219**	**26,740,478**

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të sipërcituara të ardhurat dytësore për vitin 2017, janë krijuar nga të ardhurat nga dhënja me qera e objekteve në vlerën 149,100 lekë, nga kamat vonesat në vlerën 1,005,679 lekë dhe ta ardhurat për gjobat në vlerën 10,693,228 lekë.

Për vitin 2018, nga të ardhurat dytësore, janë krijuar nga dhënja me qera e objekteve në vlerën 319,500 lekë, nga kamat vonesat në vlerën 764,761 lekë dhe të ardhurat për gjobat në vlerën 12,963,958 lekë.

Për vitin 2019, nga të ardhurat dytësore, janë krijuar nga dhënja me qera e objekteve në vlerën 42,600 lekë, nga kamat vonesat në vlerën 559,278 lekë dhe të ardhurat për gjobat në vlerën 26,138,600 lekë.

2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 64/1 datë 21.01.2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Organizimin dhe funksionimin i Inspektoriatit Shtetëror të Punës. Inspektoriati Shtetëror i Punës (ISHPSHSH) është institucion publik që ka kaluar në varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë meVKM në 503 datë 13.09.2017. ISHPSHSH është krijuar me Vendimin nr 295 datë 20.03.2013 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoriatit shtetëror të punës dhe shërbimeve shoqërore, si institucion qëndror, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës ër punën dhe cështjet sociale në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 pika 3, 51 e 56 të ligjit nr. 10 433 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* të nenit 6 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "*Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës*", të ndryshuar, të nenit 40 të ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe të nenit 26 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*" Inspektoriati Shtetëror i Punës financohet nga Buxheti i Shtetit dhe ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara me Ligj. Inspektoriati Shtetëror i Punës e ka selinë në Tiranë dhe ka vulën e vet. Organizimin dhe veprimtaria e ISHPSHSH dhe ISHP-v në rrethe rregullohet me anë të rregullores së vitit 2016 miratuar nga Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë z. B.K. Aktiviteti kryesor i ISHPSHSH është garantimi e respektimi i kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atij të shërbimeve shoqërore. ISHPSHSH-ja është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore:*a) "të punës sipas legjislacionit të punës;b) në fushën e shërbimeve shoqërore, sipas legjislacionit për shërbimet shoqërore".*

Në zbatim të ligjit të Shërbimit Civil, MFK dhe dispozitave të ligjore për pagat e punonjësve, titullari në zbatim të rregullores së brendëshme datë 31.05.2016 të miratuar nga Ministri i Ambientit dhe VKM nr.47, datë 29.01.2014, kanë miratuar strukturën organizative, procedurat e rekrutimit të stafit, përgatitjen e procedurave për punësim e plotësim të organikës, ndërsa specialisti i financës ka realizuar hartimin dhe ndjekjen e zbatimin e buxhetit, duke siguruar zbatimin e dispozitave ligjore të pagave, kontabilizim të transaksioneve financiare e menaxhimin etj.
Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 1, datë 07.01.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore", Ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, numri I punonjësve rezulton si më poshtë:

1-ISHPSHSH-ja për vitin 2017 ka patur 155 punonjës nga këto 146 Nëpunës Civil dhe 9 janë punonjës mbështetës. Në Dhjetor 2017 kanë qenë 15 vende vakante.

2-ISHPSHSH-ja për vitin 2018 me Urdhërin e Kryeministrit nr. 116, datë 31.07.2018 "Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 1, datë 07.01.2014…..", me heqjen nga struktura të specialistit të IT ka patur 154 punonjës nga këto 145 Nëpunës Civil dhe 9 janë punonjës mbështetës.
Në Dhjetor 2018 kanë qenë 14 vende vakante.

3-ISHPSHSH-ja për vitin 2019 vazhdon me 154 punonjës nga këto 145 janë Nëpunës Civil dhe 9 janë mbështetës. Për këtë vit deri në Dhjetor 2019 kemi 14 vende vakante.
Gjate periudhës objekt auditimi ka patur lëvizje në numër dhe në pozicioni "Specialist" bazuar në urdhërat e Kryeministrit për periudhën objekt auditimi. Për nëpunësit e ISHPSHSH zbatohen

procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil. Drejtori I ISHPSHSH emërohet nga Këshilli I Ministrave me propozim të MFE . Nga auditimi dokumentacionit vënë në dispozicion (listë pagesat, libri i pagave, shkresat e emërimit, si fotokopje të dosjeve të personelit, etj) konstatohet se, struktura dhe niveli pagave për secilin pozicion janë miratuar sipas lidhjes 1/3, "a-***Institucionet qëndrore të grupit të parë"*** për ISHPSHSH në nivel qëndror. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/a, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 6, kategoria II-a "Titullari", kategoria II-b "zv-Titullari", III-a grupi Drejtor , III-b grupi inspektorë IV-a dhe IV-b specialist në varësi të kriterit minimal të diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës duke përcaktuar dhe kushtet e punës. Nuk ka tejkalim të strukturës, ndërsa mos plotësimi, numri punonjësve, planifikim e realizim fondi shpenzime kosto personeli paraqiten në tabelat e mëposhtëme:

INSPEKTORIATI SHTETËROR I PUNËS - Vakancat për vitin 2019			
Nr	**Emërtesa e Pozicionit**	**Niveli(ekzekutiv**	**Kategoria e pagës**
1	DREJTOR I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	ekzekutiv	III-a
2	KRYEINSPEKTOR	ekzekutiv	III-a
3	KRYEINSPEKTOR	ekzekutiv	III-a
4	KRYEINSPEKTOR	ekzekutiv	III-a
5	KRYEINSPEKTOR	ekzekutiv	III-a
6	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
7	INSPEKTOR	ekzekutiv	IV-b
8	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
9	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
10	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
11	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
12	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
13	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b
14	INSPEKTOR	ekzekutiv	III-b

Për periudhën objekt auditimi në institucion u konstatua se deri në datë 31.12.2019 numri punonjësve ka qenë 145 punonjës, kundrejt 159 punonjësve të strukturës organizative. Mosplotësim ka dhe në ISHP e rretheve në nivele INSPEKTOR.

Struktura organizative e miratuar për periudhën objekt auditimi përbëhet nga:

EMËRTIMI	ISHPSHSH	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	ISHP	Kategori	TOTAL
		Tiran	Elbasan	Vlorë	Berat	Kukës	Lezhë	Shkodër	Fier	Durrës	Korcë	Gjirokastër	Dibër		
Kryeinpektor	1													2-a	1
zv-kryeinsp	1													2-b	
kryeinsp.rajonal		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1		III-a	12
DREJTORIA E INSPEKTIMIT PËR MARËDHËNIET E PUNËS DHE STATISTIKËN															
DREJTOR	1													II-b	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT TË MARËDHËNIEVE TË PUNËS															
PERGJEGJES SEKTORI	1													III-a	1
Inspektor	2	32	8	8	5	3	4	7	7	8	7	5	4	III-b	100
SEKTORI I ANALIZËS STATISTIKORE TË TREGUESVE TË INSPEKTIMIT															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-A	1
INSPEKTOR	2													III-b	2
DREJTORIA E INSPEKTIMIT PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË NË PUNË															
DREJTOR	1													III-a	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT TË SIGURISË NË PUNË															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-a	1
INSPEKTOR	2													III-b	2
SEKTORI I INSPEKTIMIT TË SHËNDETIT NË PUNË															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-a	1
INSPEKTOR	2													III-b	2
DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE															
DREJTOR	1													III-a	1
INSPEKTOR	4													III-b	4
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE															
DREJTOR	1													III-a	1
SEKTORI I FINANCËS															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-a	1
INSPEKTOR	2													III-b	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE BURIMEVE NJERËZORE															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-a	1
SPECIALIST	1													IV-b	1
SPEC.IT	1													IV-a	1
ARKIVIST	1														1
SHOFER	2														2
PASTRUES	1														1
NËNP.INFO	1														1
SEKTORI JURIDIK															
PËRGJ. SEKTORI	1													III-a	1
INSPEKTOR	2													IV-b	2
TOTAL	36	33	9	9	6	4	5	8	8	9	8	6			**145**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Personelit.

Në pozicionin "**INSPEKTOR**" në kolonën "***Përshkrimi i Punës***"figuron "***Arsim i Lartë***". Kjo bie në kundërshtim me *udhëzimin nr 1 datë 31.05.2017* të Departamentit të Administratës Publike, ku në seksionin 4.1.2 "*Ilustrimi hap pas hapi i procesit të hartimit të përshkrimeve të punës*", te pika 3 e tijë " *Përcaktoni fushën dhe nivelin e studimit të kërkuar për këtë pozicion pune"* thuhet : **Përcaktimi i fushës dhe nivelit të studimit në mënyrë të saktë është mjaft i rëndësishëm si për institucionin, pasi fusha e ekspertizës do t'i shërbejë përmbushjes**

pikërisht të veprimtarisë së tij në mënyrë të suksesshme. Fusha e ekspertizës për këtë pozicion është **të kryejë funksionet e veta inspektuese me dokumentacionin e standartizuar nga Inspektoriati Qendror**, në përputhje me rregulloren e brendshme të ISHPSHSH ku për këtë pozicion pune përcaktohet qartë se detyrat kryesore të inspektorit janë zbatimi i kërkesave ligjore i subjekteve të inspektimit. Përcaktimi i përshkrimit të punës vetëm me "Arsim të Lartë" bie në kundërshtim me udhëzimin e DAP pasi është i papërcaktuar dhe nuk kategorizon asnjë llojë fushe studimore.

Përcaktimi i kërkesave të veçanta nënkupton përcaktimin e nivelit arsimor dhe fushës së studimit, përvojës në punë, si dhe njohuritë dhe aftësitë që duhet të ketë një person të cilat përshtaten me këtë vend pune. Kjo bie në kundërshtim dhe me **VKM Nr. 142, datë 12.3.2014** "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, Lidhja 2/2. "*Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë*", Klasa III-B te "*Kërkesa të posaçme*", njohuri dhe aftësi: "*Njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit*' si dhe Klasa IV/-a te "*Kërkesa të posaçme*", njohuri dhe aftësi: " *Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të një profesioni, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit*".

Pagat- Të dhënat në tabelat e mëposhtëme pasqyrojnë treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2017-2019. Në total për vitin 2017 është 94%, për vitin 2018 është 91%, për vitin 2019 është 86%. . Mosrealizimi i fondit të pagave, kryesishtë ka ardhur si rezultat i mos plotesimit te struktures organike. Nga 154 punonjes ne strukture numri per periudha te caktuara ka arritur deri ne 145 punonjes.(periudha 2017-2019, 14, 14, dhe 15 persona më pak se struktura).

Nr	Viti 2017 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative +	-	Plan	Fakt	%
1	Paga	29.300.000	VKM 2017	4.500.000		33.800.000	33.334.398	94%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)							
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	5.000.000		650.000		5.650.000	5.499..320	100%
	Totali	**34.300.000**		**5.150.000**		**39.450.000**	**38.833.718**	

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.

Nr	Viti 2018 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative +	-	Plan	Fakt	%
1	Paga	35.000.000			444.000	34.556.000	31.513.795	91%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)							
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	6.765.775			56.000	6.709.775	5.203.408	78%

	Totali	**41.765.775**			**500.000**	**41.265.775**	**36.717.203**	

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.

Nr	**VITI 2019 Emertimi**	**Çelja**	**Shkresa nr. dt**	**Shpenzime Operative**		**Plan**	**Fakt**	**%**
				+	**-**			
1	Paga	126.800.000	17.10.2019 15.11.2019		9.500.000 10.311.583 14.491.228	92.497.189	79.599.113	86%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)							
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	22.340.000	17.10.2019 15.11.2019		1.000.000 3.468.922 668.814	17.202.264	13.151.642	76%
	Totali	**149.140.000**						

Burimi:ISHPSHSH

-Krahasimi përmbledhëses së listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer.

U bë krahasimi përmbledhëses së listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nënpunësi urdhërues, zbatues (drejtori i financës) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit .

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhornimi periodik i rregjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të vkm nr. 187 , datë 08.03.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunsve civilë/nëpunësve, , lidhja 1 "*Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi*" dhe lidhja nr 2, b) *Institucionet qendrore të grupit 1/3, ku bëjnë pjesë:* **Inspektoriati Shtetëror I Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**

Nga auditimi me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori IV-të 2016; 3/mujori IV-të 2017; 3/mujori III-të 2018, 3/mujori IV-të 2019) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës.. Për rrjedhoje rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve

shoqërore dhe shëndetësore" i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve. Për periudhën objekt auditimi nuk rezultuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës, ndërsa nuk është kryer asnjë pages për ndihmë ekonomike dhe nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënieve të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

Dosjet e personelit-Për nëpunësit e ISHPSHSH zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e pavarura. Nga auditimi dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", ndërsa për periudhën e audituar për cdo punonjës është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Nga verifikimi i dosjeve për marrje status i nëpunësit civil për punonjësve aktual të ISHPSHSH rezultoi se, ligji për shërbimin civil i ka gjetur punonjësit në marrëdhënie pune të cilët kanë përfituar status nëpunësi civil të konfirmuar nga DAP prej shkurtit 2015, të certifikuar edhe nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Dosjet origjinale te punonjesve administrohen nga drejtori i personelit në ISHPSHSH. Të gjitha dosjet janë plotësuar në zbatim të **Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014**, "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit*. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : **LIDHJA NR 1**. *"Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe* **LIDHJA NR 2**. *"Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit;4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;"*

3. Mbi verifikimin, realizimin dhe zbatimin të procedurave të prokurimit publik.

Për periudhën objekt auditimi, nuk janë zhvilluar procedura tenderi "Kërkesë për propozim", "I kufizuar" dhe "I hapur".

Neni 29 "Procedurat standarde të prokurimit" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, ka të përcaktuar llojet e procedurave të prokurimit publik, të cilat janë:
a) procedurë e hapur;
b) procedurë e kufizuar;
c) procedurë me negocim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
ç) kërkesë për propozime;
d) konkurs projektimi;
dh) procedurë "shërbim konsulence".

Në pikën 5 të nenit është përcaktuar se ... Për *prokurimet* me vlerë të vogël, nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoritetet kontraktore mund të përdorin procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Normalisht, kjo procedurë është objekt i auditimit të veprimeve me bankë, pasi atje mbahet dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, i cili nuk është parashikuar në programin e auditimit.

4. Vlerësimi e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Kjo pikë e programit, nuk u auditua për shkak të ndërprerjes së auditimit para afatit të përfundimit të parashikuar, nga koronavirusi.

5. Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të Drejtorive rajonale, në lidhje me personat fizike dhe juridikë vendas ose të huaj, privatë ose publikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse apo jofitimprurëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për verifikimin e zbatimit të kompentencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoratit Shtetëror etj, u zgjodh për auditim Dega Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë, pasi ajo përmban numrin më të lartë të subjekteve të mundshëm për inspektim 89,035 gjithsej, me status aktiv në QKB, ose 43 për qind të subjekteve në shkallë vendi, numrin më të madh të inspektorëve në strukturë 32 gjithsej, ose 37 për qind, numrin më të lartë të inspektimeve të programuara, për rrjedhojë konkluzionet/përfundimet për këtë Degë, e cila ka shërbyer si kampion, janë përgjithësuese dhe përfaqësuese, vlejnë për të gjithë ISHPSHSH-së.
Për këtë qëllim u audituan fizikisht, 70 dosje inspektimi të Drejtorisë Rajonale Tiranë.

Nga auditimi i tyre u konstatua se përgjithësisht praktika e ndjekur nga ana formale është në përputhje me nenin 13 "Kompetencat e përgjithshme të inspektorit dhe kontrollorit të punës" dhe nenin 14 "Kompetencat e veçanta të inspektorit dhe të kontrollorit të punës" të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës" i ndryshuar etj.

Dosjet e subjekteve të inspektuara përgjithësisht janë të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm si:
- Autorizim për të hyrë në mjediset e punës të çdo subjekti që I nënshtrohet inspektimit.
- Njoftimi i Inspektorit të Përgjithshëm për vazhdimin e procedurave të inspektimit.
- Formulari i inspektimit i plotësuar sipas rubrikave.
- Procesverbali i inspektimit.
- Vendimi përfundimtar i inspektimit.
- Autorizimi i kompanisë për përfaqësuesin e saj ne ISHPSHSH
- Listëpagesa e punëtorëve të subjektit që inspektohet etj.

Në ushtrimin e aktivitetit të ISHPSHSH, kryesisht dy janë elementët thelbësore që ndikojnë në kryerjen me sukses të misionit të saj.
- Procedura e programimit të inspektimeve.
- Procedura e kryerjes së inspektimit.

Procedura e programimit të inspektimeve.
Subjektet ekonomike të cilat do të bëhen pjesë e planifikimit mujor të inspektimit verifikohen paraprakisht, nëse janë pjesë e listës së QKB me status aktiv, e cila azhurnohet me sistemin "e-inspektimi".
ISHPSHSH-ja prej muajit qershor 2018, ka filluar procedurën e planifikimit përmes sistemit "e-Inspektimi". Prej kësaj date e në vijim, të 12 Degët Rajonale kanë pasqyruar planet mujore me përzgjedhje subjektesh për inspektim në këtë sistem.
Inspektimet e planifikuara kryhen mbi bazë të një planifikimi të miratuar. Inspektorët e punës të gjithë procesin inspektues e zhvillojnë përmes sistemit "e-Inspektimi".

Programimi i inspektimit të punës, aktualisht nuk realizohet automatikisht nga sistemi "e-inspektimi", pasi aktualisht ky sistem nuk bën përzgjedhje në mënyrë automatike të subjekteve për planifikim mbi bazë risku.

Ai hartohet nga inspektorët e punës, sipas orientimeve të Kryeinspektorëve Rajonale dhe dërgohen për miratim nga Drejtoria Qëndrore e ISHPSHSH-së pranë Inspektoratit Qëndror, i cili shprehet për miratim ose jo. Vetëm pas miratimit të tij bëhet gjenerimi i çështjeve që do të inspektohen nga degët.
Për përzgjedhjen e subjekteve për planifikim, normalisht duhet të merren në konsideratë elementët e mëposhtëm, të cilët janë pjesë e vlerësimit të riskut.
- Lloji i aktivitetit të subjektit, Një pjesë e aktiviteteve janë të klasifikuar si punë të vështira. Këtu bëjnë pjesë aktivitete si Miniera, Karriera, Ndërtimi, Prodhimi, Elektricitet, Gaz, Ujë etj dhe që kanë gjasa potencialisht për lëndime në punë.
- Subjekte të cilat në historik të tyre (3 vitet e fundit), kanë patur aksidente/incidente, me pasojë ose jo, lëndimin apo humbje jete të punëmarrësve.
- Subjekte, ndaj të cilave, janë adresuar denoncime për shkelje të dispozitave ligjore

- Subjekte, që kanë rezultuar me shkelje në raport me:
informalitet të punëmarrësve apo informalitet në pagë .
rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

- Subjekte me numër të konsiderueshëm punëmarrësish Nga procesi i planifikimit janë përjashtuar të vetëpunësuarit apo bizneset familjare.
- Subjekte që nuk i janë inspektuar më parë.
- Subjekte që nuk janë inspektuar për një kohë relativisht të gjatë, të paktën 2 vite .

Disa element me të cilët operon ISHPSHSH për këtë qëllim janë:
- Numri i subjekteve me status aktiv nga QKB, object kontrolli 200,000 gjithsej, i ndarë sipas Rajoneve.
- Numri i subjekteve/inspektimeve që planifikohen është 14,876 gjithsej, i ndarë sipas Rajoneve.
Raporti midis numrit të subjekteve që planifikohen për inspektim me numrin i subjekteve me status aktiv nga QKB objekt kontrolli përfaqëson numrin e subjekteve të kontrolluar në përqindje (14,876 : 200,000) x 100 = 7,5 për qind.

- Ngarkesa e inspektorëve me inspektime 14,876 gjithsej, e ndarë sipas Rajoneve.

Nga sa më sipër dhe në vijim, termi numër inspektimesh dhe numër subjektesh përfaqëson të njëjtën tregues.
(Nxjerrë nga "Programi vjetor i inspektimit për vtin 2020").

Për vitin 2019 .
- Numri i subjekteve është marrë nga të dhënat e INSTAT, në regjistrin statistikor të ndërrmarrjeve, sipas aktivitetit ekonomik dhe formës ligjore 162,452 gjithsej, ndarë sipas Rajoneve.
- Numri i subjekteve/inspektimeve që planifikohen është 14,322 gjithsej dhe 1076 inspektime të papalanifikuara, i ndarë sipas Rajoneve.
Raporti midis numrit të subjekteve që planifikohen për inspektim me numrin e subjekteve marrë nga të dhënat e INSTAT, përfaqëson numrin e subjekteve të kontrolluar në përqindje (14,322 : 162,452) x 100 = 8.8 për qind.

Lidhur me sa më sipër, nga audituesit u verifikua praktika e ndjekur nga Dega Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë, për planifikimin dhe inspektimet e kryera gjatë periudhës 1 tetor 2018 deri 31dhjetor 2019.
Për këtë qëllim nga Portali u zgjodhën në mënyrë rastësore 368 subjekte, cilët kanë element të përbashkët planifikimin më tepër se një herë për inspektim.
Nga auditimi i të dhënave u konstatua se:

5.1.Praktika e ndjekur nga ana formale rezulton përgjithësisht e zbatuar nga të gjithë nivelet e ISHPSHSH-së që kanë rol në planifikim, kjo verifikuar në praktikat shkresore mujore që disponon Drejtoria e Inspektimit për Marrëdhëniet e Punës dhe Statistikës, pranë Drejtorisë Qëndrore të Institucionit.

5.2. Programimi i inspektimit për përzgjedhjen e subjekteve, aktualisht nuk realizohet automatikisht nga sistemi "e-inspektimi" (pasi nuk e parashikon këtë element).
Mos zgjedhja në mënyrë automatike e subjekteve për planifikim mbi bazë risku, krijon mundësi që përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të jetë subjektive, jo e duhura që përfaqëson realisht subjektet me risk.

5.3. Në përgjithësi, për subjektet e zgjedhur për planifikim/inspektim, nuk dihet/jepet numri i punonjësve, i cili normalisht duhet të merren në konsideratë si një ndër elementët kryesor, të vlerësimit të riskut.

Në vijim "Pasqyra e inspektimeve të planifikuar dhe realizuar sipas viteve".

Pasqyra nr. 1

	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019		
	Planifikuar	Realizuar	Pa realizuar	Planifikuar	Realizuar	Pa realizuar	Planifikuar	Realizuar	Pa realizuar
Janar	299	233	66	Aksion			438	436	2
Shkurt	342	283	59	355	350	5	444	435	9
Mars	Nuk ka plan	31	0	328	314	14	317	285	32
Prill	267	220	47	302	302	0	447	418	29
Maj	337	355	-18	411	401	10	465	430	35
Qershor	348	321		454	443	11	386	377	9
Korrik	346	304	5	363	355	8	392	378	14
Gusht	133	133	2	223	218	5	Aksion		
Shtator	348	325	7	323	304	19	Aksion		
Tetor	Aksion			447	442	5	358	294	64
Nentor	Aksion			443	365	78	348	327	21
Dhjetor	Aksion			450	444	6	348	190	158
	1175	2205	404	4099	3938	161	3943	3570	373
	Ne %		14.3	Ne %		3.9	Ne %		9.5

Nga tabela konstatohet se:

5.4.1. Për vitin 2017 nuk janë realizuar inspektimet për 404 subjekte, ose rreth 14.3 për qind kundrejt totalit, për vitin 2018 nuk janë realizuar inspektimet 161 subjekte, ose rreth 3.9 për

qind kundrejt totalit dhe për vitin 2019 nuk janë realizuar inspektimet për 373 subjekte, ose rreth 9.5 për qind e totalit.
Kryesisht mosrealizimet e inspektimeve, janë për shkak se procedura e planifikimit nuk është bërë mbi bazë analizë treguesish.
Nga 3061 subjekte të cilat janë planifikuar për inspektim në këtë periudhë, 104 nuk janë realizuar/kryer deri në datë 31.12.2019.
Prej tyre veçohen 5 inspektime të planifikuara për tu kryer në tremujorit të parë të 2019, por që nuk janë realizuar deri në fund të vitit.
Normalisht Kryeinspektori Rajonal, ka patur të gjithë kohën e nevojshme për të realizuar një inspektim gjatë vitit. Në dosjet përkatëse, nuk jepet ndonjë arsye për morealizimin e inspektimeve të planifikuara në subjekte.

Ndër subjektet që janë planifikuar për inspektim, por që nuk janë realizuar evidentohen:

"X" shpk me nipt X në planin e punës të inspektorit M.M.
"X" me nipt X dhe aktivitet tregti në planin e punës të inspektores E.B.
"X" me nipt X dhe aktivitet ndertim në planin e punës të inspektorit A.K.
"X" me nipt X dhe aktivitet Ndertim në planin e punës të inspektorëve A.H. dhe B.M.
"X" me nipt X dhe aktivitet "Shërbime" në planin e punës të inspektorit B.M.

Mosrealizimi i inspektimeve të planifikuara bie ndesh me vet programin e hartur nga Kryeinspektori Rajonal, miratuar nga Inspektorati Qendor (IQ) dhe ngarkon me përgjegjësi Kryeinspektorin Rajonal Dega Tiranë A.K.

5.4.2. Një numër i konsiderueshëm subjektesh janë programuar të inspektohen deri në katër herë gjatë vitit, kurse në fakt janë realizuar deri tre inspektime më pak, ndërsa subjekte të tjerë, megjithëse janë llogaritur me risk të ulët dhe mesatar , janë planifikuar për inspektim deri dy herë.

5.4.2.1. Subjekte që janë parashikuar me risk të ulët të cilët dhe janë planifikuar mbi një herë për inspektim gjatë 2019, dhe është realizuar 1 herë:

Nga 368 subjekte gjithsej të nxjerra nga Portali, të planifikuara për inspektim gjatë periudhës tetor 2018 deri dhjetor 2019, prej tyre 67 subjekte janë llogaritur me nivel risku "I ulët", nga të cilat tre prej tyre janë planifikuar për inspektim dy herë në vit:

Subjekti "X" me nipt X dhe aktivitet " X" në planin e punës të inspektorit të punës P. M.,
"X" me Nipt X dhe aktivitet "Të Tjera",
"X", në planin e inspektorit të punës R.Sh. të miratuara nga Kryeinspektori Rajonal A.K.

Në materialin e dosjes, nuk është arsyetuar, pse është bërë planifikimi i inspektimit të subjekteve, kur niveli i llogaritur i riskut është: i Ulët.
Normalisht, 67 subjektet e planifikuara për inspektim të llogaritura me nivel risku "I ulët", nuk ka arsye të jenë pjesë e planifikimit për inspektim, e për më tepër dy herë në vit.
Sa më sipër bie ndesh me "Metodikën e vlerësimit të riskut" të hartuar nga Institucioni.

5.4.2.2. Subjekte të tjerë të cilët janë planifikuar për inspektime deri katër herë:

"X" me Nipt X, planifikuar katër herë edhe pse klasifikohet me risk mesatar, "x" me Nipt x dhe aktivitet Tregti Art Ndryshem, planifikuar dhe realizuar 3 herë edhe pse klasifikohet me risk mesatar, programuar në planet e punës të inspektorëve S.A, M.Gj, A.A. dhe B. L. dhe miratuar nga Kryeinspektori rajonal A.K.

"X", me nipt X me aktivitet tregeti hotel-bar-restorante, 4 herë planifikuar për 2019 dhe realizuar 2 herë, me risk mesatar dhe planifikohet në 2 muaj rrjesht nëntor 2019 dhe dhjetor 2019. Planifikuar në planin e punës të inspektorit M.Gj. dhe R.B. dhe miratuar nga A.K.

"X", me nipt X dhe aktivitet prodhim dhe te tjera, planifikuar 4 herë dhe realizuar 2 herë gjatë 2019 ndërkohë që klasifikohet me risk mesatar. Planifikuar në planin e punës të inspektorit M.M. dhe A.T. dhe miratuar nga A.K. Në dosje nuk ka arsyetime se pse është parashikuar 4 herë.

"X", me nipt X dhe aktivitet Ndermarrje prodhuese, planifikuar për inspektim 4 herë dhe realizuar 1 herë. Llogaritur me nivel risku mesatar dhe të lartë. Planifikuar në planin e punës të inspektorit B.M. dhe B.S. dhe miratuar nga A.K. Në dosje nuk ka arsyetime se pse është parashikuar 4 herë dhe realizuar një herë.

"X" me nipt X dhe aktivitet "Tregti" , planifikuar për inspektim 4 herë, në 4 muaj rrjesht (Nëntor2018-dhjetor 2018- janar 2019-shkurt 2019) dhe 3 herë inspektuar. Planifikuar në planin e punës të inspektorit B.M, A.M, E.B.dhe L. N dhe miratuar nga Kryeinspektori Rajonal A.K. Në dosje nuk ka arsyetime se pse është parashikuar 4 herë.

"X" me nipt X, me aktivitet "Të tjera, Parking makinash", planifikuar për inspektim 3 herë dhe realizuar 1 herë, me aktivitet për "Parking makina", niveli i llogaritur i riskut planifikuar me risk shumë të lartë dhe dy herë me nivel risku mesatar. Kryeinspektori A.T.

- "X" me Nipt X dhe aktivitet Të tjera (planifikuar për inspektim 3 herë brenda 2019 dhe realizuar 2 herë), planifikuar në planin e inspektorit A.N. në muajt mars, tetor dhe dhjetor 2019 dhe miratuar nga A.K. Për muajin tetor është planifikuar si subjekt me risk shumë të lartë dhe në dhjetor me risk mesatar.

"X" me Nipt X dhe aktivitet Tregti (Hotel-Bar-Restorante), është planifikuar për inspektim 3 herë dhe është realizuar 1 herë, niveli i llogaritue i riskut, mesatar. Planifikuar në planin e punës të inspektorit K.K. e M.M. dhe miratuar nga A.K.

"X" me nipt X dhe aktivitet Tregti hotel-bar-restorante, planifikuar për inspektim 3 herë dhe 1 herë realizuar, niveli i llogaritur i riskut: mesatar. Planifikuar në planin e inspektores K.S. dhe miratuar nga Kryeinspektori Rajonal A.K.

"X" me Nipt X dhe aktivitet Nderrmarrje prodhuese, planifikuar për inspektim 3 herë dhe 1 herë realizuar gjatë 2019, klasifikohet me risk mesatar dhe të ulët. Planifikuar në planin e inspektores A.N. dhe miratuar nga Kryeinspektori Rajonal A.K.

"X" me nipt X dhe aktivitet Tregti hotel-bar-restorante, planifikuar për inspektim 3 herë gjatë vitit dhe inspektuar 2 herë. Planifikuar në planin e inspektoreve E.K. e K.S. dhe miratuar nga Kryeinspektori Rajonal A.K.

Subjekti X me Nipt X dhe aktivitet Tregti dhe Transport është programuar për inspektim 4 herë dhe është realizuar 3 herë, në planet e punës të inspektorëve K.K, B.S, V.S, dhe R. Sh. dhe miratuar nga Kryeinspektori A.K.

5.4.3. Nga sa më sipër konkludohet se:

5.4.3.1. Për subjektet që janë parashikuar me risk të ulët, janë planifikuar mbi një herë për inspektim gjatë 2019, dhe nuk është realizuar numri I inspektimeve të planifikuara.

Në parim, normalisht, mbështetur në mënyrën se si është llogaritur ngarkesa e inspektorëve dhe llogaritjen e numrit e subjekteve të kontrolluar, çdo subjekt programohet për t'u inspektuar vetëm një herë në vit (parashikuar në nenin 26 të ligjit 10,433, datë 16.6.2011). Në varësi të gjendjes, gjetjeve (mungesa/parregullsi në dokumentacion etj.) nga ISHPSHSH, lihen detyrat përkatëse për përmirësimin e gjendjes sipas afateve të arsyeshme kohore, në përfundim të të cilit, bëhet kontrolli i realizimit të detyrave të lëna.

Nga sa më sipër:
Planifikimi i inspektimit subjekteve mbi një herë/vit është i gabuar.
Pasoja:
- Shpenzohet kohë pa efektivitet, ndërkohë që mund të shpenzohej për objekte me pritshmëri, llogaritje risku me nivel të lartë, ose të mesëm.
- Ushtrohet trysni e pajustfikuar mbi subjektet ,
- Ndikon negativisht në imazhin e Institucionit.

5.4.3.2. Subjekte që janë programuar për inspektim deri katër herë dhe janë realizuar një herë.

Vlejnë përfundimet sipas pikës 5.4.3.1.
Duke shtuar gjithashtu se:
- Një numër i konsiderueshëm subjektesh, janë planifikuar për inspektim deri katër herë në vit (në raste te veçanta 4 muaj rresht) dhe është realizuar një herë, megjithëse është llogaritur me nivel risku të lartë.
Ky mosrealizim I pajustifikuar krijon hapësira, mundësi për favorizime të ndërsjellta midis palëve subjekt – inspektor.

- Aktivitete si "Parkim makinash" etj. janë llogaritur me risk shumë të lartë (dhe përsëri, nuk janë inspektuar) ndërkohë që nuk janë të tilla.

Nga argumentet e shtruar më lart, rezulton se Drejtoria Rajonale Tiranë, në përzgjedhjen e subjekteve për planifikim, nuk ka marrë në konsideratë elementët, të cilët janë pjesë e vlerësimit të riskut si:
- Subjekte që nuk janë inspektuar për një kohë relativisht të gjatë, të paktën 2 vite.
- Subjekte që nuk i janë inspektuar më parë etj.

DR Tiranë ka bërë planifikimin e inspektimeve për rreth 4,000 subjekte (që përbëjnë 4 për qind të totalit) mbështetur në "*Përzgjedhjen rastësore"* të subjekteve nga lista prej 89,000 subjektesh të evidentuar nga QKB.

Nga të dhënat rezulton se mbi 10 për qind e subjekteve të përzgjedhur janë planifikuar deri 4 here në vit, çka kompromenton në themel jo vetëm "*Përzgjedhjen rastësore"* të subjekteve, por në tërësi procesin e planifikimit dhe realizimit të inspektimit që ka bërë DR Tiranë.

ISHPSHSH, nuk kishte "Metodologji të vlerësimit të riskut" të miratuar, çka ka ndikuar në problemet e trajtura më lart.

Ish Kryeinspektori i Drejtorisë Rajonale Tiranë z. A.K. ka bërë vërejtje nga të cilat, një pjesë e tyre është pranuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të auditimit.
Në vijim janë dhënë përmbledhur "Vërejtjet" dhe reflektimi ndaj tyre i grupit të auditimit.
Në "Vërejtet", nuk janë pasqyruar vërejtjet e bëra nga inspektorët e veçantë, pasi ato janë paraqitur/përfshirë edhe nga Kryeinspektori i Drejtorisë Rajonale Tiranë, për rrjedhojë gjejnë përgjigje aty.

"Vërejtje" nr. 1:
Se pari *ne lidhje me gjetjen e auditimit pika 3 se nga verifikimi i 368 subjekte gjithesej te nxjerra nga Portali per te cilat rezultoi se nje numer subjektesh jane progrmuar te inspektohen deri ne kater here gjate vitit, kurse ne fakt jane realizuar rreth tre inspektime me pak, dhe ne materielet e dosjeve nuk eshte arsyetuar frekuenca e planifikimit te inspektimeve*, ju sqaroj se:
Referuar projekt raportit ne rubriken 5.4.2.2 subjekte te programuara per inspektim kater here ka rezultuar se:
Subjekti 'X", ***me nipt X*** *nga gjetjet ka rezultuar se eshte planifikuar kater here edhe pse me risk mesatar.*
Nga verifikimi i dosjes se inspektimeve te planifikuar ndaj ketij subjekti ne Portal rezulton se ne vitin 2018 jane realizuar 3 inspektime dhe referuar autorizimit te çdo inspektimi rezulton se inspektimet jane realizuar ne tre adresa te ndryshme konkretisht ne inspektimin e planifikuar nga inspektorja S.A eshte realizuar ne adresen kryesore Rr. Presidenti George Bush, kullat perballe Parlamentit; nga inspektori M.Gj. inspektimit eshte realizuar eshte kryer ne degen e subjektit me adrese Rr. "Kavajes" , Blloku i magazinave "Misto Mame"; dhe ne Inspektimin e planifikuar nga inspektorja A.A. inspektimi eshte realizuar ne adresen Rr. "Muhamet Gjollesha".
Per vitin 2019 rezulton vetem nje here i planifikuar ne planin e punes se inspektorit B.L dhe i realizuar ne adresen qendrore te subjektit per shkak te numrit te konsiderueshem te punemarresve te punesuar ne seline qendrore te tij. Arsyet e frekuences se planifikimit per inspektim gjate vitit 2018 gjenden ne dokumentacionin e inspektimit si autorizimi i inspektimit ne rubriken adresa ku do te kryhet inspektimi ne te cilen verifikohet qartazi se inspektimet jane kryer ne adresa te ndryshme ku jane kontrolluar kushtet e punes dhe verifikuar zbatimi i legjislacionit te punes si ne selin qendore dhe ne deget e subjektit per ku ushtron veprimtarin.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Mbështetur në metodologjinë e ndjekur nga Institucioni në bashkëpunim me IQ, çdo subjekt planifikohet për inspektim vetëm një herë, pavarësisht nëse ai përbëhet nga një njësi, ose disa filiale. Për të realizuar, është detyrë e Kryeinspektorit të bëjë organizimin duhur të grupeve të inspektimit, me qëllim nxjerrjen e produktit përfundimtar të inspektimit për tërësinë e subjektit të inspektuar, brenda afatit të planifikuar, duke reflektuar ndër të tjera menaxhim efektiv të procesit të planifikimit.
Ky qëndrim i audituesit është i vlefshëm edhe për "Vërejtjet" në vijim, pasi ato janë të njëjta/ngjashme, ndryshon vetëm subjekti i auditimit.

"Vërejtje" nr. 2: **Subjekti " X" me nipt X**, ku nga auditimi ka rezultuar se subjekti eshte planifikuar kater here ne vitin 2019 dhe eshte realizuar vetem dy here.

Nga verifikimi i dosjes se subjektit ne portal rezulton se eshte planifikuar dy here per inspektim gjate vitit 2019 konkretisht ne planin e muajit Korrik 2019 nga inspektori A.L. me Nr.ISHPSHSH-Tr-2019-002732 ceshtjeje por per shkak te zbatimit te urdherit te Kryeinspektoit me Nr. 148, date 09.07.2019 "Per Zbatimin e Planit Operacional per Inspektimet ne Sezonin Turistik Veror 2019", gjate te cilit grupet e inspektimit u angazhuan teresisht me inspektimet ne zonen bregdetare, plani i muajit Korrik 2019 tashme i hartuar dhe miratuar nuk ka munduar te realizohet brenda ketij muaji, dhe inspektimi eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.Nderkohe qe inspektimi i realizuar nga inspektori R.A. ndaj subjektit ishte planifikuar dhe realizuar ne planin e muajit Janar 2019 me nr.ISHPSHSH-TR-2018-005010.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se subjektet qe ishin pjese e planit te punes kane perparesi nga planifikimet e tjera, pasi presupozohet qe kane patur arsye qe jane planifikuar ne muajin Korrik. Muaji dhjetor i realizimit të tij, është pas një kohe relativisht të largët dhe tregon një planifikim jo korrekt, që çon në një menaxhim jo efektiv të kohës së punës, unifikimit dhe përpunimit të të dhënave të inspektimit si një tërësi etj.

"Vërejtje" nr. 3: **Subjekti "X" me NIPT X,** nga auditimi rezulton se subjekti ka qene i planifikuar kater here gjate vitit 2019, madje planifikuar ne dy muaj rresht Nentor ,Dhjetor 2019 dhe realizuar vetem dy here.

Nga verifikimi i dosje se subjektit ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar vetem nje here gjate vitit 2019 ne planin e punes se muajit Korrik 2019 te inspektorit R.B dhe ne pamundesi per tu realizuar plani per shkak te zbatimit te urdherit Nr. 148 date 09.07.2019 "Per Zbatimin e Planit Operacional per Inspektimet ne Sezonin Turistik veror 2019", inspektimi eshte realizuar ne muajin Nentor 2019 me Nr. ISHPSHSH-Tr-2019-002572 dhe procesi eshte mbyllur ne respektim te afateve ligjore me vendim perfundimtar ne muajin Dhjetor 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 4 here konkretisht ne muajin Dhjetor 18; Korrik 19; Nentor 19 dhe Dhjetor 2019. I njejti arsyetim si me siper per vonesen e planifikimit.

Subjekti "X" NIPT X, ku nga auditimi rezulton se eshte planifikuar kater here dhe realizuar dy here gjate 2019.

Nga verifikimi i dosjes ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar per inspektim dhe realizuar tre here gjate vitit 2019, ne planifikimin e muajit Shkurt 2019 te inspektorit M.M. me Nr. ISHPSHSH-2019-000093 , inspektim i realizuar ne Degen e subjektit me adrese Rr. "Dritan Hoxha", Pallati Green Construction, Zogu i Zi; ne planifikimin e muajit Prill nga inspektori X me Nr.Tr-ISHPSHSH-2019-000963 eshte realizuar ne Dhjetor 2019 dhe ceshtja eshte mbyllur me vendim perfundimtar ne respektim te afateve ligjore ne Janar 2020, ky inspektim eshte realizuar ne adresen Njesia "Bashkiake Nr. 2, Rr. "Gramoz Pashko", Pll 3 , Kati 1. Gjithashtu ne planifikimin e muajit Tetor 2019 te inspektorit X i realizuar brenda muajit ceshtja me nr.ISHPSHSH-TR-2019-0003665.

Arsyet e frekuences se inspektimit ndodhen ne dosje ne dokumentacionin e inspektimit Autorizim Inspektimit, konkretisht vendi adresa e kryerjes se inspektimit e cila eshte e ndryshme ne secilin prej inspektimeve te kryera.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 4 here konkretisht ne muajin Shkurt, Prill, Tetor dhe Dhjetor te viti 2019. Rezultojne dy adresa. Per vitet 2018 dhe 2017 ka vetem nga 1 inspektim, qe nuk justifikojne 4 here planifikim per vitin 2019 kur nuk ka ndryshime thelbesore aktiviteti.

Subjekti "X" me NIPT X, nga auditimi ka rezultuar se subjekti eshte planifikuar kater here dhe eshte realizuar vetem nje here.
Nga verifikimi i dosjes ne portal rezulton se subjekti ka qene i planifikuar per inspektim vetem dy here respektivisht njehere ne vitin 2018 i planifikuar per inspektim ne planin e muajit Dhjetor nga inspektori B.M. me Nr.ISHPSHSH-TR-2018-0004393 inspektim i realizuar, si dhe nje here ne vitin 2019 planifikuar ne muajin Qershor ne Nr.ISHPSHSH-TR-2019-002087 nga inspektorja B.S. ku per shkak te trajtimit te ceshtjeve te inspektimit jashte programit (ankesa, aksidente etj) te cilat kane bere te pamunduar realizimin e ceshtjeve te planifikuara duke bere te mundur realizimin e ketij inspektimit ne Janar 2020 dhe procedura e perfunduar me vendim perfundimtar ne muajin Shkurt.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin (*planet e derguara nga Inspektorati I Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Dhjetor 2018 dhe Qershor, Nentor te viti 2019. Realizuar 1 here per periudhen e audituar nga keto planifikime.

Subjekti "X", me NIPT X, nga audititmi ka rezultuar se subjekti eshte planifikuar per inspektim 4 here ne 4 muaj rresht (Nentor- Dhjetor 2018 dhe Janar-Shkrut 2019), por nga verifkimi i dosjes ne portal rezulon se subjekti eshte planifikuar per inspektim ne Janar 2019 ne planin e punes se inspektores E.B. me Nr.ISHPSHSH-TR-004966 , dhe inspektimi eshte realizuar ne adresen Qendra Tregetare City Park; eshte planifikuar dhe realizuar ne planin e muajin Dhjetor 2018 nga inspektori L.N. me Nr.ISHPSHSH-2018-Tr-004549 inspektimi eshte kryer ne adresen Qendra Tregtare Ring Center; eshte planifikuar per inspektim ne planin e muajit Shtator 2018 te inspektoreve B.M. dhe B.S. ne dy adresa te ndryshme ne inspektimin e planifikuar nga inspektori B.M. i cili nuk eshte realizuar eshte planifikuar nje inspektim ne qendren tregtare X, kurse ne inspektimin e realizuar nga inspektorja tjeter me Nr.ISHPSHSH-2018-TR-003089 eshte realizuar ne adresen X.
Si perfundim rezulton se cdo inspektim eshte kryer ne adrese te ndryshme dhe inspektimet jane planifikuar duke marre parasysh se subjekti ne cdo dege ku ushtron aktivitetin ka te punesuar mbi 10 punemarres nje numer i konsiderueshem per ta marre baze ne planifikimin e inspektimeve vertetuar nga dokumentacioni i inspektimit Formular Inspektimi, duke zbatuar ne planifikim kete menyre edhe nje nga pikat ku bazohet vleresimi i riskut te nje subjekti sic eshte edhe numri i punemarresve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: I njëjtë si më lart.

Subjekti "X " sh.p.k me NIPT X gjate auditimin rezultoi se subjekti ishte planifikuar 3 here dhe eshte realizuar vetem nje here, nga verifikimi i dosjes se subjektit ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar per inspektim vetem nje here gjate vitit 2018 ne planin e punes se

muajit Shtator 2018 te inspektores S.A. Nr. ISHPSHSH-TR-2018-002881 i cili eshte realizuar, si dhe nje here ne vitin 2019 ne planin e punes se muajit Korrik 2019 me Nr.ISHPSHSH-TR-2019-002795 nga Inspektori A.T. inspektim i cili per shkak te zbatimit te urdherit Nr. 148 date 09.07.2019 "Per Zbatimin e Planit Operacional per Inspektimet ne Sezonin Turistik veror 2019" eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati I Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Korrik, Tetor dhe Dhjetor te viti 2019. Realizuar 1 here per periudhen e audituar nga keto planifikime.

Subjekti "X" me NIPT X, ku nga auditimi rezultoi se subjekti eshte planifikuar per inspektim 3 here brenda vitit 2019 dhe eshte realizuar vetem dy here, nderkohe qe nga verifikimi i dosjen ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar per inspektim nje here e vitin 2018 ne planin e muajit Mars 2018 me nr.ISHPSHSH-TR-2018-000445 nga inspektori M.M. si dhe dy here per vitin 2019 ne planin e muajit Mars 2019 me Nr.ISHPSHSH-TR-2019-000615 nga inspektori A. N. gjate te cilit subjektit ju lane detyra per tu realizuar ku per te pare realizimin e tyre eshte bere planifikimi i inspektimit ne muajin Tetor 2019 me Nr.ISHPSHSH-TR-2019- 0003442, por per shkak te zbatimit te urdherit nr.148,date 09.07.2019 per sezonin turistik veror 2019 percaktuar edhe sa me siper, inspektimi u realizua ne muajin Dhjetor 2019 nga i cili subjekti rezultoi me detyra te realizuara (verifikuar ne dokumentacionin e inspektimit Formular inspektimit).

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Mars, Tetor dhe Dhjetor te vitit 2019. Kontrolli i realizimit te detyrave nga subjektet nese kane nje rendesi duhet te kete perparesi dhe jo shtyrje ne kohe.

Subjekti "X" me NIPT X, nga auditimi rezulton se eshte programuar per inspektim 3 here dhe eshte realizuar 1 here, por nga verifkimi i dosjes se subjektit ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar dy here per inspektim nje here ne vitin 2018 ne planin e punes se muajit Nentor 2018 nga inspektori K.K, me nr. ISHPSHSH-TR-2018-003967 inspektim i cili eshte realizuar ne Degen e subjektit me adrese Rr. "Dritan Hoxha", pallatet Gintash referuar Autorizimit te Inspektimit , si dhe ne vitin 2019 eshte planifikuar nje inspektim ne planin e punes se muajit Korrik 2019, ne Nr.ISHPSHSH-TR-2019-002529 nga inspektori M.M. i cili ka realizuar inspektimin ne selin e subjektit perseri referuar vendit te inspektimit me adrese Njesia Bashkiake Nr.9, Rr. "Jordan Misja", Pall 99, shk1, kati2, per shkak te zbatimit te Urdherit Nr.148 , date 09.07.2019 per sezonin turistik veror inspektimi eshte realizuar ne Janar 2020.
Pra rezulton se subjekti eshte planifikuar per inspektim nje here ne vit dhe inspektimet jane realizuar ne adresa te ndryshme ku ushtron aktivitet subjekti, ne lidhje me mosrealizmin brenda muajit Korrik 2019 kjo per arsye te zbatimit te Urdherit te Kryeinspektorit Nr. 148, 09.07.2019 sic kemi arsyetuar edhe me siper ne ceshtje te planifikuara ne muajin Korrik 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati I Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin

Nentor 2018, Korrik dhe Dhjetor te vitit 2019. Duhet te ishte administruar procesi i planifikimit ne nje muaj me grupe te ndryshme.

Subjekti "X" me NIPT X, ku nga auditimi ka rezultuar se eshte programuar per inspektim 3 here dhe eshte realizuar 1 here nga verifikimi i dosjes se subjekti nga portal rezulton se subjekti eshte planifikuar vetem nje here per inspektim ne vitin 2019 nga inspektorja K.S. ne planin e muajin Korrik 2019 me nr. ISHPSHSH-TR-2019-002655 dhe inspektimi nuk eshte mundur te realizohet kete muaj per shkak te zbatimit te urdherit per inspektimet per sezonin turistik veror 2019 dhe eshte realizuar ne Dhjetor 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati I Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajinTetor, Korrik dhe Dhjetor te vitit 2019. Duhet te ishte administruar procesi i planifikimit ne nje muaj me grupe te ndryshme.

Subjekti "X" me NIPT X, nga auditimi ka rezultuar se eshte planifikuar 3 here per inspektimi dhe eshte realizuar vetem nje here ne 2019, nderkohe qe nga verifikimi i dosjes ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar dy here per inspektim gjate vitit 2019 ne planifikimin e muajit Shkurt dhe eshte realizuar ceshtja me Nr.ISHPSHSH-TR-2019-000034, inspektim gjate te cilit subjektit i jane lene detyra dhe per kontrollin e realizimit te te cilave eshte planifikuar per inspektim dhe ne planin e muajit Tetor 2019, cili per shkak te trajtimit te ceshtjeve te inspektimit jashte programit eshte realizuar ne Dhjetor 2019 ne Nr.ISHPSHSH-TR-2019-003448 .

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Shkurt, Tetor dhe Dhjetor te vitit 2019.

Subjekti "X" me NIPT X, ku nga auditimi rezultoi se subjekti ishte planifikuar per inspektim 3 here gjate vitit dhe ishte realizuar 2 here nderkohe nga verifikimi i dosjes se subjektit ne portal rezulton se subjekti gjate vitit 2019 eshte planifikuar per inspektim 2 here ne planin e muajit Mars 2019 me Nr.ISHPSHSH-TR-2019-000614, i cili eshte realizuar nga inspektorja E.K. ne adresen Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Donika Kastrioti si dhe ne planin e muajit Tetor 2019 me Nr. ISHPSHSH-Tr-2019-0003494 nga inspektorja K.S. i cili u realizua ne adrese te subjektit Bulevardi Deshmoret e Kombit, Dy Kullat Binjake Kati 3 planifikim i cili u krye bazuar ne faktin se subjekti kishte te punesuar nje numer te konsiderushem punemarresisht (19) dhe gjate inspektimit te pare i ishin lene detyra mbi kushtet e sigurise ne pune, por per shkak te zbatimit te urdherit per sezonin turistik veror 2019 inspektimi eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Mars, Tetor dhe Dhjetor te vitit 2019. Muaji dhjetor i realizimit eshte kohe e gjate dhe flet per mungesen e nje sistemi pune per planifikim efektiv. Duhet te ishte administruar procesi i planifikimit ne nje muaj me grupe te ndryshme.

Subjekti "X"me NIPT X, ku nga auditimi ka rezultuar se subjekti eshte planifikuar 3 here per inspektim dhe eshte realizuar 1 here ne 2019, nga verifikimi i dosjes së subjektit në Portal rezulton se subjekti eshte planifikuar vetem dy here gjate vitit 2019 në planin e Inspektoreve A.K.me muajin Korrik 2019 me Nr. ISHPSHSH-TR-2019-002447 ku inspektimi eshte realizuar brenda muajin, gjate ketij inspektimi sujektit ju lane detyra per tu realizuar ne kohe ne lidhje me gjetjet e konstatuara qe kishin te benin me ceshtjet e sigurise dhe shendetit ne pune si dhe pageses se oreve shtese, duke marre ne konsiderate llojin e aktivitetit te subjektit "ndertim" i cili klasifikohet me risk te larte si dhe rendesine e realizimit ne kohe te detyrave te lena eshte planifikuar per inspektim ne planin e muajin Tetor 2019 ne planin e punes se inspektorit A.L. ku inspektimit nuk ka mundur te realizohet brenda muajit per shkak te zbatimit te urdherit per sezonin veror 2019 eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes se vene ne dispozicionin tone (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt eshte planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 3 here konkretisht ne muajin Korrik, Tetor dhe Dhjetor te vitit 2019. Planifikimi inspektimit në muajin dhjetor (tepër larg), tregon mungesen e nje sistemi pune per planifikim efektiv, në veçanti kur subjekti është vlerësuar me nivel risku të larte.

Subjekti "X" me NIPT X, ku nga auditimi ka rezultuar se subjekti eshte planifikuar 4 here dhe eshte realizuar 3 here, nga verifikimi i dosjes se subjektit ne portal rezulton se subjekti eshte planifikuar nje here per inspektim ne vitin 2018 ne planin e muajit Nentor 2018 te inspektorit K.K.me Nr. ISHPSHSH-TR-2018-0003981 dhe inspektimi eshte realizuar ne adresen Rruga Industriale Kashar, si dhe eshte planifikuar per inspektim vetem 2 here gjate vitit 2019 ne muajin Shkurt nga inspektorja B.S. Nr. ISHPSHSH-Tr-2019-000156 ku inspektimi eshte realizuar ne Degen ku ushtron aktivitetin subjekti referuar vendit te inspektimit ne autorizimin e inspektimit me adrese Kryqezimi i Rruges Presidenti Bush me bulevardin ZhanD'Ark, Kati i Pare Hotel x si dhe eshte planifikuar ne muajin Nentor 2019 nga inspektorja V.S. me Nr. ISHPSHSH-TR-2019-0004022 e cila ka realizuar inspektimin ne adresen tjeter ku ushtron aktivitet subjekti Rr. "Ferit Xhajko" te subjektit referuar vendodhjes se inspektimit ne dokumentacionin autorizim inspekimi.
Në të treja rastet inspektimi është planifikuar dhe realizuar në adresa të ndryshme ku subjekti ushtron aktivitet.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se nga Planet e punes së vënë në dispozicionin tonë (*planet e derguara nga Inspektorati i Punes ne Inspektoratin Qendror*), ky subjekt është planifikuar per inspektim per periudhen e audituar 4 here konkretisht ne muajin Nentor 2018 dhe Shkurt ; Nentor dhe Dhjetor te vitit 2019. Duhet te ishte administruar procesi i planifikimit në një muaj me grupe të ndryshme.

Subjekti "X" me NIPT X, eshte planifikuar per inspektim ne muajin Mars 2019 ne planin e punes se inspektorit A.K. inspektimi nuk ka mundur te realizohet per disa arsye objektive për shkak të trajtimit te çështjeve jashtë programit (aksidente, ankesa), duke vijuar në muajin Prill 2019 planifikimi është orientuar nga Drejtoria Qendrore per planfikimin e inspektimeve ne subjektet qe ushtrojne aktivitet fason.Per shkak te zbatimit te urdherit Nr. 148 date 09.07.2019 per sezonin turistik veror 2019.

Pas perfundimit te sezonit veror 2019 inspektori i ceshtjes A.K. nuk eshte paraqitur ne pune per shkak te gjendjes se paaftesise shendetesore (vertetuar me raport mjekesor) duke arsyetuar ne kete menyre mosrealizimin e inspektimit prane ketij subjekti deri ne dt.07.11.2019.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Shtohet gjithashtu se mos realizimit ne kohe te gjate flet per mungesen e nje sistemi pune per planifikim efektiv. Mungesa e nje inspektori nuk duhet te lere nje subjekt te planifikuar per inspektim pa kryer, pasi kjo duhet te ishte adresuar ne planet e muajit pasardhes ne inspektor tjeter.

Subjekti "X" me NIPT X, i cili sipas gjetjeve ne raport ka rezultuar se eshte planifiikuar per inspektim nga inspektori R.A dhe nuk eshte realizuar, nga verifikimet e kryera si ne Portal per ceshtje te inspektimit te krijuar per subjektin X me numrin e niptit te dhene sa me siper nuk rezultoi asnje ceshtje, madje dhe nga verifikimi i kryer ne QKB nipti nuk i korenspondon ketij subjekti dhe asnje subjekti tjete., arsye per te cilat pa evidnetuar subjektin nuk mund te shprehem mbi arsyen e realizimit ose jo te inspektimit ndaj ketij subjekti.
Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Subjekti eshte marre nga lista e planeve te muajit Janar 2019, te vena ne dispozicion.

Subjekti "X" me NIPT X ne raport ka rezultuar se ky subjekt ka qene i planifikuar per inspektim ne planin e inspektori A.H. dhe B.M, nga verifikimi ne portal rezulton se subjekti ishte planifikuar per inspektim ne planin e punes se muajit Mars 2019 me nr.ISHPSHSH-TR-2019-00804, te inspektorit B.M. inspektimi nuk ka munduar te realizohet nga inspektori i ceshtjes per shkak te largimit te tij nga puna.
Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Mungesa e nje inspektori nuk duhet te lere nje subjekt te planifikuar per inspektim pa kryer, pasi kjo duhet te ishte adresuar ne planet e muajit pasardhes ne inspektor tjeter.

Vërejtje: *Nga sa analizuam me larte ne menyre te permbledhur konkludojme se ka mosperputhje midis gjetjeve te auditit dhe verifikimit te dosjeve te subjekteve nga Portali per ceshtjet:*
Ne shumicen e rasteve ka mosperputhje te numrit te planifikimit te inspektimeve te realizuara ndaj nje subjektit dhe atyre te konkluduara ne projekt raportin e auditit.
Arsyetimi i ferkuences se planifikimit dhe realizimit te disa inspektimeve ndaj nje subjekti ekziston dhe eshte e parashikuar ne dokumentacionin e inspektimit konkretisht te Autorizimi i Inspektimit vendi ku do te kryhet inspektimi te cilat kane qene te ndyshme ne rastete e analizuara me siper; Formulari i inspektimit ku percaktohet numri i punemarresve si dhe Vendimi perfundimtar i inspektimit ku pasqyrohen detyrat e lena per realizim.
Referuar dosjeve te subjekteve te audituara jane planifikuar subjekte me nivel risku mesatar dhe te larte, kryesisht planifikimi i subjekteve me nivel risku mesatar duke mos lene asnjehere te paperfshire ne planifikimet mujore subjekte me riskt te larte, eshte bazuar kryesisht te numri i punemarresve i cili ka qene i konsiderueshem si dhe referuar denoncimeve ne drejtim te subjektit si dhe incidenteve apo aksidenteve te dodhura ne to.

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Te dhenat e auditit jane te dhena te Planeve mujore te derguara nga ISHPSHSH-ja prane IQ per miratim. Kjo liste eshte ballafaquar me numrin e inspektimeve te kryera te mara nga portali i inspektimit. Nga shenimet e mesiperme ka vetem 1

rast mosperputhe qe ben fjale per subjetin "X" me NIPT X, pasi eshte marre se bashke me nje subjekt tjeter nga Nipti pothuajse i njejte (me ndryshin ne nje shifer)

Vërejtjet lidhur me subjektet:
"X", "X", "X", "X" "X", "X", "X", "X", "X", "X", "X", qëndrojnë, pranohen dhe reflektohen në Projektraport.

Përfundime të Kryeinspektorit A.K.

*Sa me siper analizuam konludojme ne nje perfundim se per te subjektet e analizuara me perjashtim te dy subjekteve qe i perkisnin inspektorit A.K. per te cilen kemi dhene arsyetimin ne trajtimin e ceshtjes dhe subjektit te planifikuar nga inspektori B.M. i cili nuk eshte realizuar per shkak te largimit nga detyra po ate muaj, te gjitha inspektimet e planifikuara jane realizuar,*gje qe deshmon qartazi impenjimin maksimal ne funksion te zbatimit te detyrave funksionale qe inspektimet e programuara te mund te realizohen te gjitha brenda vitit kalendarik.

Se treti *ne lidhje me gjetjen e auditimit parashikuar ne piken 4 te projekt raportit ku eshte evidentuar se : Gjate periudhes Tetor 2018 deri ne Dhjetor 2019 nga 368 subjekte te planifikuara per inspektim gjithesej nga Portali, 67 prej tyre jane llogaritur me nivel risku "te ulet", tre prej te cilave jane planifikuar per inspektim dy here ne vit. Ne dosje nuk eshte arsyetuar pse eshte bere planifikimi i subjekteve kur niveli i riskut eshte llogaritur i ulet, ju sqarojme se*;
Me urdherin nr.173, date 06.09.2018 "Mbi bashkepunimin rajonal ne lidhje me perditesimin e listeve te subjekteve" te Kryeinspektorit te ISHPSHSH, dega u urdherua per disponimin e "Regjistrit te subjekteve" ne forme elektronike, per subjektet qe ushtronin aktivtet ne qarkun perkates , ku informacioni baze do te merrej nga bashkepunimi me Qendren Kombetare te Biznesit , liste e cila do te sherbente si baze per programet mujore te inspektimit.
Duke qene se nga bashkepunimi me QKB kerkoheshin subjekte te reja te regjistruara cdo muaj duke nisur nga muaji Tetor 2018 e ne vijim ne zbatim te urdherit , informacioni i percjelle nga QKB permbante vetem me te dhenat mbi subjektet e reja si (emer,NIPT, te dhenat mbi administratorin, llojin e subjektit X apo Juridik, aktivitetin adrese kryerose , apo deget ku ushtronte aktivitet) te regjistruara cdo muaj pa numer punemarresish duke mos me dhene mundesin per te llogaritur paraprakisht riskun. Perzgjedhja e subjekteve nga listat e QKB per planin mujor te inspektimeve ishte teper i veshtire pasi behej vetem duke marre per baze dy tregues i)inspektim per here te pare ii) lloji i aktivitetit qe ushtronin qe ne shumicen e rasteve ku ne nje lloj ishin te pershira edhe shume lloje te tjera aktiviteti pa lidhje me njeri- tjerin, duke e sjelle veshtiresi e cila hasej kryesisht ne terren nga inspektoret nga te cilet evidentoj se subjekti ushtronte ate lloj aktiviteti per te cilin risku llogaritej i vogel.
Vetem gjate realizimit te planit mujor me zhvillimin e inspektimeve fizike ne subjekt arrihej te llogaritej niveli real i riskut nga vete inspektori i cili ne shumicen e rasteve per subjektet e perzgjedhur per planifikim nga listat e QKB ka rezultuar i ulet per disa arsye:a) shumica prej tyre rezultonin te mbyllura edhe pse ende kishin statuas aktiv te deklaruar ne QKB pasi planifikimi hartohej ne muajin paraardhes; b) disa subjekte ende nuk kishin nisur te ushtronin aktivitetin e tyre, apo rezultonin vetem me administratorin te deklaruar ende ne fazat e para organizimit te aktivitetit.
Ne ato subjekte te cilat nga inspektimi ka rezultuar se niveli i riskut eshte llogaritur i ulet nga inspektoret e ceshtjes, eshte perjashtuar perfshirja e tyre ne planet e inspektimit gjate ne vijim.

Ne vijim te ketij arsyetimi ju sqaroj edhe ne lidhje me gjetjen ne raportin e auditimit se tre prej ketyre subjekteve jane planifikuar dy here ne vit, edhe pse jane llogaritur me nivel risku te ulet duke evidetuar per secilin prej tyre si me poshte se:

Subjekti "X" me NIPT X , nga verifikimi ne portal rezulton vetem nje here i planifikuar vetem ne vitin 2019 ne planin e punes se muajit Korrik 2019 te Inspektorit P.M. mr Nr. ISHPSHSH-TR-2019-002578, i cili per shkak te zbatimit te urdherit per sezonin veror 2019 eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.

Shenim i audituesit: Frekuenca Korrik- Dhjetor e madhe pasoja sqaruar më lart.

Subjekti "X" me Nipt X, nga verifikimi ne portal rezulton se subjekti gjate vitit 2019 eshte planifikuar dhe realizuar vetem nje here per inspektim ne planin e muajit Korrik 2019 me Nr. ISHPSHSH-TR-2019-002746 te inspektorit R.Sh. ku per te njejten arsye per shkak te zbatimit te urdherit per sezonin veror 2019, inspektimi eshte realizuar ne muajin Dhjetor 2019.

Shenim i audituesit: Frekuenca Korrik- Dhjetor e madhe pasoja sqaruar më lart.

Ne lidhje me subjektin "X" te analizuar ne raport e kam te pamundur te shprehem pasi per shkak te mungeses se niptit subjekti nuk mund te evidentohet, nga kontrolli ne portal me emer nuk rezulton.

Ne lidhje me konstatimin e grupit te auditit mbi metodiken e planifikimit ku konstatohet se Dega Rajonale Tirane ka bere planifikimin e inspektimeve per rreth 4000 subjekte (4 % e totalit) mbeshtetur ne perzgjedhjen rastesore te subjekteve nga lista prej 89.000 subjektesh te evidentuar nga e QKB ju sqarojme se:

Duke qene se perzgjedhja e subjekteve nga lista e QKB nuk mund te behej ne baze te riskut per shkak te mugeses se elementin kryesor numrit te punemarresve, dhe si pasoje sjelljen e rezultave te ulta ne pune planifikimi eshte kryer duke perzgjedhur pjesen dermuese te subjekteve, nga lista te percjella nga Drejtoria Rajonale Tirane ne zbatim te urdherit Nr.173 date 06.09.2018 "Mbi bashkepunimin rajonal ne lidhje me perditesimin e listave te subjekteve", e cila eshte e detajuar dhe rifreskuar me te dhenat e permuajshme mbi numrin e punemarresve te subjekteve. Ne keto lista gjithesej rezultonin se ushtronin aktivitet per qarkun e Tiranes ne total 46,395 subjekte nga te cilat pas filtrimit manual te kryer kane rezultuar se 24,086 rezultojne subjekte me 1 te punesuar ose vetepunesuar te cilat jane perjashtuar nga planifikimi, pjesa tjeter rreth 15, 724 subjekte kane rezultuar me 4 punemarres dhe 6.585 subjekte me mbi 5 punemarres te cilet jane perfshire ne planifikim duke marre si prioritet numrin e te punesuarve, duke theksuar gjithashtu se referuar llojit te aktivitetit ne pjesen dermuese te listave mbizoteron "Tregetia".

Pra planifikimi i inspektimit ne pergjithesi bazohej te listat e subjekteve te percjella nga DRT Tirane dhe pjeserisht perfshiheshin edhe subjekte te reja te painspektuara me pare te perzgjedhur nga listata e QKB-se si kriter planifikimit inspektimi per here te pare, subjekte te perballura me incidente ne pune, subjekte te cilave i adresohej numri me i madh i denoncimeve per moszbatim te legjislacionit te punes.

<u>Qëndrimi i audituesit të KLSH -së</u>: Bashkëpunimi ndërinstitucional është detyrë e Kryeinspektorit Rajonal. Dega Rajonale Tirane ka nje historik te inspektimeve te kryera prane subjekteve, te cilat ne shumicen e rasteve kane periudhe te ushtrimit te aktivitetit vite me parë.

Se treti *ne lidhje me gjetjen nga auditimi se gjate vitit 2017 nuk jane realizuar inspektime ne 404 subjekte rreth 14,5 % kundrejt totalit, ne vitin 2018 nuk jane realizuar inspektime ne 161*

subjekte rreth 3,9 % e kundrejt totalit si dhe ne vitin 2019 nuk jane kryer inspektime ne 373 subjekte rreth 9,5% kundrejt totalit, dhe eshte konkuduar se Kryeinspektori Rajonal ka patur gjithe kohen e nevojshme per te realizuar inepsktime gjate vitit, si dhe ne dosjet perkatese nuk ka arsyetim pse nuk jane realizuar, ju sqaroj se:

Referuar tabeles me te dhenat per vitet përkatese 2017, 2018 dhe 2019 "Pasqyra e planifikimit dhe realizimit sipas viteve",verifikimi është kryer dhe rezultatet jane nxjerr bazuar ne te dhenat mbi numrin e inspektimeve te programuara per cdo muaj ne raport me numrin e inspektimeve te realizuara nga progami mujor, por nuk jane evidentuar inspektimet e kryera jashte programit te inspektimit cdo muaj te cilat jane pjese e punes se inspektorit ku per trajtimin e tyre ndiqet e njejta procedure dhe zbatohen te njejtat afate ligjore njesoj si ato te planifikuara gje e cila ben te pamundur ezaurimin e te gjitha inspektimeve te planifikuara, duke sjelle si rezultat spostimin e tyre per realizim ne muajt ne vijim ku prioritet eshte realizimini sa me pare te subjekteve me nivelin e riskut me te larte, sa me poshte paraqes te dhenat mbi inspektimet e realizuar cdo muaj jashte programit per vitin 2017;

Muaji	Plan	Realizim	
		Planifikuara	Jashte programit
Janar	299	233	66
Shkurt	342	283	28
Mars		31 (nga shkurti)	36
Prill	267	220	53
Maj	337	355	44
Qershor	348	321	35
Korrik	346	304	31
Gusht	133	133	24
Shtator	348	325	18
Tetor	Aksion		9
Nentor	Aksion		22
Dhjetor	Aksion		23

Bazuar ne te dhenat nga tabela nuk me rezultojne parealizuar 404 subjekte sic eshte konkludur ne raport, pasi nga 59 inspektime te parealizuara nga plani i muajit Shkurt 2017, 31 prej tyre eshte mundur te realizohen ne muajin Mars 2017 duke lene nje diference prej 28 subjektesh parealizim te cilat jane realizuar pjeserisht ne muajin Maj 2017, i cili rezulton me teper realizim pra 18 subjekte me shume te realizuara nga plani;dhe ne muajin Gusht 2017 eshte realizuar gjithe plani i parashikuar.Mos realizimi i inspektimeve te programuara brenda muajt respesktiv gjate vitit 2017 eshte i bazuar ne disa arsye si me poshte:

- Per shkak te numrit te inspektimeve jashte programit (Ankesa, Aksidente , leje per te mitur, autorizim per fillimin e punimve, ore shtese etj), i cili ishte sa diferenca e inspektimeve te planifikuara dhe te parealizuara ne cdo muaj duke i spostuar ne muaj ne vijim.

- Ne muajin Shkurt 2017 me Urdherin Nr.95, date 16.02.2017 "Per Kryerjen e Inspektimeve On Line" te Inspektoratit Qendror nepermjet te cilit urdherohej kryerja e gjithe inspektimeve on line nepermjet kiteve portable, per problematikat e zbatimin e ketij urdheri nga Dega Rajonale Tirane u be menjehere me dije Kryeinspektori me shkresesn nr.132 prot, date 06.08.2017 se per shkak te mungeses se bazes materiale (USB, boje printer portaleb etj) si dhe shume

problemeve te tjera teknike me te cilat perballeshin inspektoret, realizimi i inspektimeve te planifikuara ne keto kushte nuk mund te realizohej. Kjo problematike na ka shoqeruar per nje kohe te gjate pothuaj deri ne muajin Qershor ku jane realizuar edhe trajnime te vecanta per grupet e inspektimit.

- Inspektimet e planifikuara dhe e mbetura pa realizim ka qene e pamundur te realizoheshin deri ne fund te vitit per shkak te pjesmarrjes se grupeve te inspektimin ne aksionin e realizuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, tre muajt e fundit Tetor-Nentor-Dhjetor 2017.

- Referuar planifikimit ashtu sikurse jeni ne dijieni nga Qershori i vitit 2017 e ne vijim ne vitet 2018, 2019 objekt kontrolli kryehej planifikimi mujor nepermjet programit e-insepektime, si rrejdhimisht ceshtjet e programuara per inspektim por te parealizuara mund te verifikohen edhe nga portal e-inspektion.

Ne vitin 2018 Dega Rajonale Tiirane ne zbatim te Urdherit Nr.130 date 29.06.2018 "Evidentimin dhe kontrollin e subjekteve qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne sezonin turistik" , per periudhen Korrik-Shtator 2018 periudhe te ciles po ti referohemi tabeles se auditimit nuk eshte pasqyruar, duke nxjerre si konkluzion nje dieference te madhe subjektesh te planifikuara dhe te parealizuara, gjitheshtu edhe nga verifikimet ne portal rezultatet nuk jane te njejta por diferenca eshte me vogel dhe ekzistojne arsye per mosrealizim si me poshte vijon:

Nga verifikimi ne portal per periudhen 01.01.2018-31.12.2018 rezulton se me poshte:

Ceshtje me stasus "Te mbyllur" rezultojne per 4387 subjekte

Ceshtje me status "Te hapur" rezultojne per 23 subjekte;

Ceshtje me status "ne progres" rezultojne 2 subjekte.

nga te cilat pjesa dermuese e subjekte te planifikuara dhe te parealizuara per inspektim i perkasin inspektorit Erjon Rasa i cili nuk i ka rezlizuar pasi eshte larguar nga puna.

Referuar planifikimit te vitit 2019 , Urdheri Nr.148 Date 09.07.2019 "Per zbatimin e planit operacional per inspektimet ne sezonin tueristik veror 2019" ka filluar efektet e zbatimit te tij qe nga muaji Korrik deri ne Shtator 2019, arsye e cila argumenton me se mire pse planifikimi i muajit Korrik 2019 nuk ka mundur te realizohet dhe prej tij jane realizuar vetem ato subjekte te planifikuara te cilat ushtronin aktivitet vetem gjate sezonit turistik (si resorte, pishina etj).

Nga ana tjeter nga verifikimi ne portal per periudhen 24.12.2018 (gjenerimi i planit te muajit Janar 2019 sipas Urdherit Nr.172, date 04.09.2018) -31.12.2019 rezulon se:

Ceshtje me Status "Te hapura" jane krijuar nga ana ime per 87 subjekte, nga te cilat shumica e inspektimeve te parealizuara i perkasin : i)planifikimit te inspektorit A.K. kryesisht per planin e muajit Tetor 2019 i cili e ka patur te pamundur realizimin e tyre per shkak te gjendjes se paftesise ne pune (vertetuar me raport shendetesor) e cila ka filluar pas zbatimit te urdherit per sezonin turistik veror 2019 gjendje e cila ka vijuar;ii) subjekte te planifikuara per inspektim nga inspektori B.M. planin e muajit Qershor 2019 te cilat nuk u realizuan per shkak te largimit te tij nga puna; iii)ceshtje te planifikuara nga inspektorja . A.A. ne planet e muajve Qershor, Korrik 2019 te cilat nuk u realizuan per shkak te marrjes se lejen se barrelindjes nga inspektorja, dhe pjeserisht ceshtje te programuara per inspektim nga inspektori I. B te cilat nuk mund te realizoheshin per shkak te gjendjes se paaftesise shendetesore te inspektorit per nje perjudhe 3 mujore (vertetuar me raport shendetesor) duke sjelle vonesa ne realizimin e tyre ;

Ceshtje me status "ne progres" rezultojne 6 nga te cilat nuk jane mbyllur ceshtjet e inspektorit B.M. per arsyet e dhena sa me siper si dhe V. H. per shkak te largimin te saj nga puna;

Rezultojne me status "te mbyllur" 3199 subjekte , ku dalim ne konkluzionin se numri i subjekteve te planifikuara dhe te parealizuar rezulton me pak dhe mosrealizimet jane te mbeshtetura ne argumeta.

Nga ana tjeter me lejoni t'ju sjell ne vemendjen tuaj se planifikimi i realizmit te inspektimeve te planifikuara dhe parealizuara per vitin 2019, nga ana ime per kete vit eshte monitoruar deri me dt.07.11.2019 date te cilen me urdher te Kryeinspektorit u transferova per te kryer perkohesisht detyren time ne Degen Rajonale Elbasan.
Arsyet sa me siper per planifikimin e viti 2019 jane dhene nga ana ime ne shpegimet e derguara me e-mail nga per ceshtjet e kerkuara nga grupi i auditimit per periudhen Mars-Tetor 2019, si me poshte vijon;

	Planifikuar	Realizuar nga planifikimi	realizuar jashte planifikimit				realizuar ne total
			Ankesat	aksidentet	rastesor	Tematik	
Mars	317	286	23	7	4	7	327
Prill	447	389	41	6	3	7	446
Maj	465	393	28	2	8	2	433
Qershor	386	355	23		24	4	406
Korrik	392	348	39	7	136	13	543
Gusht		3	21	2	71	5	102
Shtator		1	36	12	157	8	214
Tetor	358	255	51	4	47	2	359
	2365	2030					**2830**

Ne perfundim te gjithe sqarimeve dhe komenteve te mija sa me siper , shpresoj qe te merren ne konsiderate nga grupi i auditimit ne perpilimin e raportit perfundimtar .
Shpegimet dhe komentet e dhena i bazoj ne dokumentacionin e si me poshte vijon:

1. *Urdher Nr. 148, date 09.07.2019 " Per zbatimin e planit operacional per inspektimet ne sezonin turistik veror 2019"*
2. *Urdher Nr. 173, date 06.09.2018 " Mbi bashkepunimin rajonal ne lidhje me perditesimin e listave te subjekteve"*
3. *Urdher nr. 130 date 29.06.2018 "Evidentimin dhe kontrollin e subjekteve qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne sezonin turistik"*
4. *Urdher nr.172 date 04.09.2018 'Mbi percaktimin e detyrave dhe afateve ne lidhje me programet mujore te inspektimit dhe realizimit te tyre nga trupa inspektuese"*
5. *Urdher nr.95, date 16.2.2018 "Per kryerjen e inspektimeve on line"*
6. *Shkresa nr. 132 prot, date 06.03.2017 ' Ne lidhje me kryerjen e inspektimeve on line"*

Qëndrimi i audituesit të KLSH -së: Në përgjithësi arsyetimet e Kryeinspektorit DR Tiranë, tentojnë të justifikojnë praktikën e ndjekur, por ato nuk prekin thelbin e problemeve të evidentuar nga grupi i auditimit që janë:
- Kryerja e inspektimeve më shumë se një herë në të njëjtin subjekt. Në parim, normalisht, mbështetur në mënyrën se si është llogaritur ngarkesa e inspektorëve dhe llogaritjen e numrit e subjekteve të kontrolluar, çdo subjekt programohet për t'u inspektuar vetëm një herë në vit (parashikuar në Metodikën e Institucionit dhe nenin 26 të ligjit 10,433, datë 16.6.2011) pavarësisht numrin të filialeve etj. Pikërisht kjo është detyrë e Kryeinspektorit të

organizojë/përfundojë inspektimin brenda afatit kohor ligjor me një ose më shumë grupe inspektimi.
- Përfshirja në planifikim për inspektim e subjekteve që janë llogaritur me nivel risku të ulët. Këtu nuk ka çfar të komentohet.
- Mos kryerja e numrit të planifikuar të inspektimit në të njëjtin subjekt sipas shembujve të paraqitur në projektraport dhe raportin e auditimit.

Konkluzioni është bazuar në të dhënat që ju paraqitën grupit të auditimit. Tabela e planeve të punës nuk reflektonte spostimin apo mbartjen e një subjekti të planifikuar në një muaj për tu riprogramuar në muajin pasardhes, qoftë dhe ne formen e shenimeve. DR Tiranë në praktikën e saj, nuk ka ndjekur me prioritet inspektimet për subjektet e mbetura të painspektuara nga plani mujor aktual, të kryheshin në muajin pasardhës, ndërkohë që ato janë përfshirë në muajin dhjetor.
Planet e punës të inspektorëve të larguar, me raport mjekësor etj, duhet te rivlerësoheshin në planet e inspektoreve të tjerë në muajin pasardhës më të afërt.
Lista e subjekteve të cilat planifikohen per tu inspektuar duhet të përmbush elementet, që lidhen me vlerësimin e riskut për inspektimin e punës. Planifikimi i subjekteve për inspektim nuk lidhet me emrin e inspektorit, por me efikasitetin e inspektimit të punës në DR Tiranë.

INFORMALITETI

Sipas ligjit nr. 10,433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, termi "Punësimi informal", është përcaktuar si një marrëdhënie punësimi, që nuk u nënshtrohet nga ana ligjore, ashtu edhe në praktikë, kërkesave të legjislacionit të punës dhe ligjit për procedurat tatimore dhe ku punëmarrësi nuk përfiton të drejtat e tij, që burojnë nga këto ligje.
Në ligj janë qartësuar gjithashtu dhe mjetet ligjore të ndërhyrjes, (masa urgjente nga pezullimi i pjesshëm deri në pezullim të plotë të punës) nga inspektori i punës, me qëllim formalizimin e punësimit informal.

Të dhënat mbi punën në të zezë apo punësimin e padeklaruar.
Të dhënat i përkasin kategorisë së punëmarrësve informal të konstatuar të padeklaruar në subjekte formale apo të licensuara dhe aktivitete që zhvillohen krejtësisht në të zezë apo të pa licensuara. (Në këtë mënyrë raportohet zyrtarisht nga ISHPSHSH-ja, duke dhënë vetëm shifrën e punëmarrësve informalë të konstatuar).
Kështu për Vitin 2017 janë raportuar 607 punëmarrës informalë, për vitin 2018 janë raportuar 1580 punonjës informalë dhe për vitin 2019 janë raportuar 2879 punonjës informal.
Ligji nuk ka një metodikë të përcaktuar për të përllogaritur dhe shprehur Informalitetin.

Në këtë situatë, duke mos pasur njësi matëse referuese, për të krijuar një ide se si është punuar lidhur me Informalitetin, si është trendi tij tij, shihet dinamika e tij, përmirësimi/keqësimi i tij nga viti në vit dhe midis Drejtorive Rajonale.
Në vijim jepen të për informalitetin për periudhën 2017 – 2019 gjithsej për Institucionin dhe për Degën Rajonale Tiranë në veçanti.

	Viti 2017				Viti 2018				Viti 2019			
	12 DR		Tirane		12 DR		Tirane		12 DR		Tirane	
	PM informal	PM u siguruan	PM informal	PM u siguruan	informal	u siguruan	informal	u siguruan	informal	u siguruan	informal	u siguruan
Janar	39	38	9	9	4	2	2	0	93	82	28	27
Shkurt	86	86	13	13	24	24	1	1	107	106	65	65
Mars	81	79	9	7	9	9	2	2	97	95	29	29
Prill	85	83	1	1	33	29	9	6	89	88	40	40
Maj	103	101	3	1	97	95	22	22	186	166	39	38
Qershor	32	32	4	4	131	128	34	31	152	147	73	73
Korrik	73	69	17	17	132	129	14	13	713	701	137	132
Gusht	66	64	7	7	85	73	15	8	627	625	36	36
Shtator	42	24	5	5	177	175	13	13	501	488	101	99
Tetor	0	0	0	0	473	459	131	125	172	160	58	55
Nentor	0	0	0	0	296	276	37	28	69	69	24	24
Dhjetor	0	0	0	0	119	116	36	36	73	67	24	22
	607	**576**	**68**	**64**	**1580**	**1515**	**316**	**285**	**2879**	**2794**	**654**	**640**

Në pasqyrë është dhënë numri i punonjësve informalë të Degës Rajonale Tiranë në raport me totalin e informalëve të konstatuar nga 12 degët;

- për vitin 2017 është në masën 11.2 % (68 punemarres informalë të Degës Tiranë në raport me numrin gjithsej i institucionit 607)
- në vitin 2018 në masën 20% (316 punemarres informalë të Degës Tiranë në raport me numrin gjithsej 1580)
- në Vitin 2019 në masën 22.2 % (654 punëmarres informalë të Degës Tiranë në raport me numrin gjithsej 2879)

Nga pasqyra konstatohet se megjithëse DR Tiranë ka rreth 37 për qind të inspektorëve, në rastin më të mirë në vitin 2019, ka gjetur/evidentuar 20 për qind të punëmarrësve informal.

Lidhur me raportin punëmarrës informal të konstatuar me numrin e inspektorëve në DR Tiranë.
Gjatë vitit 2017, numri i punëmarrësve informal të konstatuar nga inspektimet, në raport me numrin e inspektorëve është 2 punëmarrës informal për një inspektor për gjithë vitin nga DR Tiranë, ndërkohë që Dega Vlorë rezulton me 11.2 informal për inspektor dhe Dibra me 35 informal për inspektor.

Gjatë vitit 2018 numri i punëmarrësve informal të konstatuar nga inspektimet, në raport me numrin e inspektorëve është 9.8 punëmarrës informal për inspektor për gjithë vitin për Degën Tiranë, Dega Vlorë me 27.3 punëmarrës informal për inspektor dhe Dega Dibër me 35 punonjës informalë për inspektorë.

Për vitin 2019 numri i punëmarrësve informal të konstatuar nga inspektimet, në raport me numrin e inspektorëve është 20.4 informal për inspektor, Dega Vlorë me 62.3 unëmarrës informal për inspektor dhe Dega Dibër me 32.5 punëmarrës informalë për inspektorë. (*për vitin 2019 kjo degë ka punuar në shumicën e kohës me dy inspektorë gjithsej*)

Duke patur parasysh se numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitete ekonomik është i përqëndruar kryesisht në këtë qark, rezultatet e konstatimit të informalitetit në DR Tiranë, reflektojnë situatën e një planifikimi inspektimi dhe realizimi të tij në terren me probleme.

Krahas sa më sipër, ekziston dhe një kategori tjetër informaliteti që përfaqëson pjesën e padeklaruar të pagës apo të marrëveshjes mes punonjësve dhe punëdhënësve dhe që prek një masë shumë të madhe të bizneseve. Këtu është fjala për informalitetin (gri), për të cilët japin tregues si Punëmarrës pa kontrata individuale, ku për vitin 2017 janë konstatuar 968 punëmarrës, për vitin 2018 janë konstatuar 2018 dhe për vitin 2019 janë konstatuar 1479 punëmarrës. *Në këtë tregues janë vetëm numri i punëmarrësve pa kontrata pune, pasi në tregusit që raporton ISHPSHSH-ja në numrin e punëmarrësve pa kontrata, përfshihet dhe numrin e punëmarrësve të padeklaruar, të cilët faktikisht janë dhe pa kontrata pune. Shifra e mësipërme është llogaritur si diferencë me numrin e punëmarrësve informalë, me totalin e punëmarrësve pa kontrata pune të raportuar nga ISHPSHSH-ja.*

ISHPSHSH-ja zotëron të dhëna për punëmarrës që sigurohen mbi pagë minimale, pa kontratë pune, mosrespektimin e shtesave në pagë për punë të kryer jashtë kohës normale, në orë shtesë, ditë pushimi javor, punë e kryer ne turne të dyta e të treta, në ditë të festave zyrtare etj. si elementë të kontratës së punës, por nuk ka gjetur mënyrën për t'i shprehur/konvertuar këto të dhëna mundësisht në një tregues të vetëm dhe referues, të informalitetit me qëllim përdorimin e tij në procesin e inspektimit.

Tregues inspektimi të realizuar në periudhën 2017-2019, që publikon ISHPSHSH-ja janë si më poshtë :

Pasqyra nr. 3

Tregues Inspektimi	***Viti 2017***	***Viti 2018***	***Viti 2019***
Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	7958	12297	13079
Vende pune të inspektuara	182154	291244	296808
Punëmarrëse femra		140834	147542
Mesatare e punëmarrës për subjekt	22.8	23.6	22.6
Subjekte private të inspektuara	7923	12222	13015
Vende pune të inspektuara në subjektet private	176744	272296	282782
Punëmarrëse femra		140837	142239
Mesatare e punëmarrës për subjekt në subjekte private	22.2	22.2	21.7

Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	1575	3661	4358
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	633	1443	1706
Punëmarrës informal të evidentuar	607	1580	2879
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	252	467	994
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	576	1515	2794
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH		467	970
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	309	329	255
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	157	154	88
Punëmarrës të huaj të evidentuar	1746	2074	1106
Punëmarrës të huaj, pa leje pune	7	20	18
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	196	324	195
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	52	74	59
Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative "Pezullim" për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës	221	844	1568
Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative "Pezullim" për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë e shëndetit në punë	2	11	151
Subjekte me masën administrative "Paralajmërim"		1538	1692
Subjekte me masën administrative "Gjobë"	80	175	160
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	13746	28914	38162.2
Inspektime për shkak Ankese	264	467	600
Inspektime për shkak Aksidenti	115	162	197
Punëmarrës të aksidentuar	137	195	176
Punëmarrëse femra të aksidentuara		30	24
Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	18	27	38

Grupi i auditimit, mbështetur në treguesit e pasqyrës, gjykon se krahas sa më sipër, element/tregues orientues, nxitës dhe matës për performancën e inspektorëve mund dhe duhet të jetë:

- *Numri i inspektimeve të realizuar për një punonjësve informal.*
Për vitin 2017 është 5 inspektime (subjekte) për një punonjës informal.
Për vitin 2018 është 3.4 inspektime (subjekte) për një punonjës informal.
Për vitin 2019 është 3.6 inspektime (subjekte) për një punonjës informal.

- *Numri mesatar i punonjësve informal të konstatuar për një inspektor gjatë vitit.*
Për vitin 2017 është konstatuar 6.1 punonjës informal për inspektor.
Për vitin 2018 është konstatuar 16.1 punonjës informal për inspektor.
Për vitin 2019 është konstatuar 29.4 punonjës informal për inspektor.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë (*ISSAI 4000* [2]) të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij.
Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.
Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, i kryer në subjektin Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi,

[2]- **ISSAI 4000 –** Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

që nën gjykimin profesional të audituesit janë jo materiale, të shkaktuara nga interpretimi i gabuar i dispozitave ligjore, të cilat cenojnë ndjeshëm, substancialisht misionin e Institucionit, për të cilin japim **opinion të kualifikuar[3].**

B. PROPOZIM PËR VENDOSJE TREGUESISH.

ISHPSHSH periodikisht publikon periodikisht "Treguesit e inspektimit", të cilët japin të dhëna që lidhen kryesisht me subjektet objekt inspektimi, si, numri i subjekteve të inspektuar, vende pune të inspektuara, punëmarrës femra\meshkuj, punëmarrës informal etj.
Grupi i auditimit, pasi u njoh me treguesit e publikuar, gjykon se tregues të tjerë, orientues, nxitës dhe matës për performancën e inspektorëve mund dhe duhet të jenë:

- Numri i inspektimeve të realizuar në vit për një punonjësve informal.
- Kryerjes së inspektimeve më shumë se një herë në të njëjtin subjekt.
- Përfshirja në planifikim për inspektim e subjekteve që janë llogaritur me nivel risku të ulët.
- Mos kryerja e numrit të planifikuar të inspektimit në të njëjtin subjekt.
- Numri mesatar i punonjësve informal të konstatuar për një inspektor gjatë vitit (*Trajtuar në faqen 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: ISHPSHSH, nuk ka hartuar dhe miratuar "Metodologjinë e vlerësimit të riskut", në kundërshtim me pikën 2 neni 24 të Ligjit nr. 10,433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ...
Programimi i inspektimi hartohet nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin periodik në rastet e parashikuara nga ligji i posaçëm.

[3] -Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së**, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura, ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.
Sipas përcaktimeve të **kreut II, pika 2.3 të Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së**, "Në disa raste, mospërputhshmëria edhe pse jo materiale nga ana sasiore, mund të jetë **materiale nga ana cilësore – siç mund të jenë natyra ose përmbajtja - duke ndikuar kështu në konkluzionet e auditimit"**(faqe 17). Normalisht "Opininoni i kualifikuar" jepet kur aktiviteti i kryer nga Institucioni konstatohet me devijime/ shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit janë të rëndësisë materiale, pra kushtëzohet nga fakti që deviacionet nga kuadri ligjor dhe rregullator të kenë pasojë diferenca materiale. Në rastin konkret, evidentohen deviacione/ shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, që megjithëse nuk janë të rëndësisë materiale, audituesi e gjykon të japë opinion të kualifikuar, pasi interpretimi i gabuar i dispozitave ligjore, ka cenuar ndjeshëm, substancialisht misionin e Institucionit, nëpërmjet: *Kryerjes së inspektimeve më shumë se një herë në të njëjtin subjekt, Përfshirjes në planifikim për inspektim e subjekteve që janë llogaritur me nivel risku të ulët, moskryerjen e numrit të planifikuar të inspektimit në të njëjtin subjekt etj.*

Materiale të ndryshme në ISHPSHSH, veçanërisht për programimin e inspektimeve, merren në bazë të vlerësimit të riskut, dhe i referohen "Metodologjisë së vlerësimit të riskut", shtatë elementëve përbërës të tij, por në asnjë rast grupit të auditimit, nuk ju vendos në dispozicion "Metodologji e vlerësimit të riskut" e miratuar.

Rekomandimi: ISHPSHSH të hartojë dhe të miratojë në Institucionet përkatëse "Metodologjinë e vlerësimit të riskut", e cila do të shërbeje si bazë e certifikuar për programimin e inspektimeve, duke eliminuar elementët negativë të vërejtur si: programimi disa herë në vit i një subjekti, programimi i inspektimit të subjekteve me nivel risku të ulët etj (*Trajtuar në faqen 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: ISHPSHSH planifikimin e inspektimit për përzgjedhjen e subjekteve, e mbështetet në të dhënat e QKB të azhurnuara dhe portalin "e-Inspektim".
Aktualisht, programimi i inspektimit për përzgjedhjen e subjekteve, nuk realizohet automatikisht nga Portali (pasi nuk e parashikon këtë element).
Mos zgjedhja në mënyrë automatike e subjekteve për planifikim mbi bazë risku, ka krijuar mundësi që përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të jetë subjektive, jo e duhura që përfaqëson realisht subjektet me risk.
Kjo ka bërë që subjekti/subjektet:
- Të përzgjidhen për inspektim deri katër herë në vit, në kundërshtim me metodikën e planifikimit, e cila e parashikon një herë në vit,
- Të përzgjidhen për inspektim, megjithëse janë parashikuar me nivel risku të ulët.
- Të përzgjidhen për inspektim, megjithëse numri i punonjësve që kanë është një shifror, ndërkohë që normalisht, ai është një ndër elementët kryesor të vlerësimit të riskut etj.

Pasojë e kësaj përzgjedhje:
- Shpenzohet kohë pa efektivitet, ndërkohë që mund të shpenzohej për objekte me pritshmëri, llogaritje risku me nivel të lartë, ose të mesëm.
- Ushtrohet trysni e panevojshme mbi subjektet ,
- Ndikon negativisht në imazhin e Institucionit.

Në tërësi sa më sipër bie ndesh me "Metodikën e vlerësimit të riskut" të hartuar nga vet Institucioni.

Rekomandimi: Për të korrigjuar sa më sipër, ISHPSHSH të marrë çdo vit numrin e punonjësve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (Portali nuk e disponon numrin e punonjësve) për llogaritjen e nivelit të riskut dhe ti japë përparësi kryesisht programimit të inspektimeve në subjektet, të cilat kanë numrin e fuqisë punëtore më të lartë.
Për këtë qëllim, fillimisht të evidentohen subjektet sipas numrit të punonjësve dhe nisur nga mundësitë që ka ISHPSHSH, të përcaktohet inspektimi i tyre në radhë zbritëse, aq sa lejon ngarkesa e inspektorëve të ISHPSHSH (*Trajtuar në faqen 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i 368 subjekteve gjithsej të nxjerra nga Portali, rezultoi se një numër i konsiderueshëm subjektesh janë programuar të inspektohen deri në katër herë gjatë vitit, kurse në fakt janë realizuar deri tre inspektime më pak.
Në materialin e dosjes, nuk është arsyetuar kjo frekuencë e planifikimit të inspektimeve.

Në parim, normalisht, mbështetur në mënyrën/metodikën se si është llogaritur ngarkesa e inspektorëve dhe llogaritjen e numrit e subjekteve të kontrolluar, çdo subjekt programohet për t'u inspektuar vetëm një herë në vit.
Ndërkohë, mosrealizimi i numrit të inspektimeve të planifikuara, në parim, krijon mundësi për favorizime të ndërsjella midis palëve subjekt - inspektor.
Për më tepër, kur një subjekt është programuar të inspektohet deri 4 muaj rresht, kompromettohet jo vetëm cilësia e planifikimit të inspektimit të subjekteve, por dhe vet figura e inspektorit.
Sa më sipër bie ndesh me planifikimin e inspektimeve të hartuar nga inspektorët, Kryeinspektori Rajonal, miratuar nga Inspektorati Qendror.

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës tetor 2018 deri dhjetor 2019, nga 368 subjekte gjithsej të nxjerra nga Portali, të planifikuara për inspektim, 67 prej tyre janë llogaritur me nivel risku "I ulët", tre prej të cilëve, janë planifikuar për inspektim dy herë në vit.
Në materialin e dosjes, nuk është arsyetuar, pse është bërë planifikimi i inspektimit të subjekteve, kur niveli i llogaritur i riskut është: i Ulët.
Sa më sipër bie ndesh me "Metodika e vlerësimit të riskut" të hartuar nga Institucioni (*Trajtuar në faqen 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 nuk janë realizuar inspektimet për 404 subjekte, ose rreth 14.3 për qind kundrejt totalit, për vitin 2018 nuk janë realizuar inspektimet 161 subjekte, ose rreth 3.9 për qind kundrejt totalit dhe për vitin 2019 nuk janë realizuar inspektimet për 373 subjekte, ose rreth 9.5 për qind e totalit.
Normalisht Kryeinspektori Rajonal, ka pasur kohën e nevojshme për të realizuar një inspektim gjatë vitit. Në dosjet përkatëse, nuk jepet ndonjë arsye për mosrealizimin e inspektimeve të planifikuara në subjekte.
Sa më sipër bie ndesh me planifikimin e inspektimeve të hartuar nga inspektorët, Kryeinspektori Rajonal, të miratuar nga Inspektorati Qendror (*Trajtuar në faqen 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit faktik të buxhetit për vitin 2017, 2018, 2019 në zërin shpenzime operative, llogaria 602 konstatohet se janë kryer shpenzime në nën/zëra të cilat nuk kanë qenë të planifikuar në buxhetin vjetor. Këto shpenzime janë në vlerën 725,732 lekë për vitin 2017 dhe për vitin 2018 në vlerën 2,719,151 lekë dhe për vitin 2019 është 3,866,085 lekë. Në llogarinë 602, rezulton se nga 32.138.077 lekë të planifikuara është shpërndarë sipas zërave të kësaj llogarie vlera 25,323,000 lekë duke lënë pa shpërndarë vlerën 5,815,077 lekë. Konstatohet se në zëra të veçantë ka tejkalim të shpenzimeve kundrejt planifikimit vjetor.

Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Sektori i Financës të marrë masa që gjatë hartimit të planit vjetor të buxhetit, të bëjnë një ndarje sa më të saktë të shpenzimeve për llogarinë 602 në mënyrë që të eliminohen shpenzimet e paplanifikuara si dhe realizimet mbi planifikim (*Trajtuar në faqen 8-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit të vitit 2017, 2018 si dhe të vitit 2019, kurse për vitin 2018 mungon Raporti i monitorimit vjetor.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2017 dhe vitit 2019, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me kreun IV "Monitorimi", të Udhëzimit nr. 9, dt. 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimin e buxhetit" të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku citohet se " Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet te përmbajë:
- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;
- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;
- Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;
Në raportet e monitorimit mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimet dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre. ISHPSHSH nuk ka bërë publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare.

Rekomandimi: Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të marrë masa që për periudhën në vijim, Raportet e monitorimit të buxhetit të hartohen me një informacion të plotë si dhe me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar,_në përputhje me paketën ligjore në fuqi (*Trajtuar në faqen 8-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në vazhdimësi

D. Shënim:
Programi i auditimit, nuk është realizuar plotësisht, për shkak të ndërprerjes së auditimit para afatit të përfundimit, nga korona virusi.
- Nuk është realizuar pika nr 4, "Vlerësimi e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit" e programit të auditimit**.**
-Është realizuar pjesërisht pika nr. 5 "Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të Drejtorive Rajonale...", e programit të auditimit, lidhur kryesisht me kryerjen e auditimit në terren, të cilat do të auditohen përgjatë vitit në vazhdim.

IV. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe Aktverifikimi nr. 1, datë 31.3.2020 me objekt "Hartimi dhe zbatimi i buxhetit".

Shënim:
1. Programi i auditimit, nuk është realizuar plotësisht, për shkak të ndërprerjes së auditimit para afatit të përfundimit, nga korona virusi.
- Nuk është realizuar pika nr 4, "Vlerësimi e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit" e programit të auditimit**.**
- është realizuar pjesërisht pika nr. 5 "Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të Drejtorive Rajonale..." e programit të auditimit.

Për sa më lart paraqitet ky Raport Auditimi.

Drejtori Departametit

Bashkim Arizaj

Audituesit shtetëror
të KLSH-së
F. Z
M.Ll.
G.Sh.
H.K.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tabela e Shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1.	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
2	ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbi
7	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
8	INSTAT	Instituti i Statistikës
9	QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
10	APP	Agjencia e Prokurimit Publik
11	LPP	Legjislacioni i Prokurimit Publik
12	OE	Operator ekonomik
13	BOE	Bashkim i operatorëve ekonomikë
14	KVK	Kriteret e Veçanta të Kualifikimit
15	Sh.p.k.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar